



KËSHILLA

Përmbajtja/ Mars 2009 (Nr. 34)


Do të lexoni:



Kur'ani – Libri i Urtësisë 5



Mall dhe dashuri për Profetin 6



All'Ilahu – Profetët – Njerëzit 10



Vdekja është 'porta' e Ahiretit 28

e të tjera...

KËSHILLA

Nr. 34, Mars, 2009
Organ i Fondacionit të Kur'anit

Drejtör:
Prof. Muhammed Reza
HAXH KHEZR

Kryeredaktore:
Liseda RAMAJ

Drejtör artistik:
Vullnet MERJA

Korrektör:
Vjollca FEZA

Design & Layout:
Aurora SHEHU

Bashkëpunuan:
Vullnet MERJA,
Vjollca FEZA,
Sabrie FEZA,
Selim STAFJA,
Majlinda NDRECA,
Jefmir ÇELA etj.



Me emrin e All'Ilahut,

Adresa: Rr. Hoxha Tahsim Nr. 168
Kutia Postare: 8272
Tel & Fax: 00355 42 377 311
Tirana – Albania
WebSite: www.fquran.com
E-mail: f_quran114@yahoo.com



I urojmë të gjithë myslimanëve

Gëzuar Ditëlindjen e Profetit Muhammed (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!)

Njerëzimi, epokë pas epoke, gjatë evoluimit, ka treguar se besimi është ai që ka udhëhequr shpirtat e tyre. Por, kur flasim për besim, përkushtimi ndaj Zotit, është pikësynimi ynë. Sakrifica, dëshira, vullneti mbajnë zgjuar vetëdijen e njeriut në përmbushjen e porosive të All'llahut. Kohë pas kohe, Zoti i Madhëruar u ka dërguar njerëzve Profetë për t'i udhëzuar ata në rrugën e së Vërtetës. Profeti Muhammed (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!), i Dërguari i fundit i All'llahut, përmendet në Kur'an: **"Kush respekton Profetin, ka respektuar All'llahun..."** (En Nisa, 80); kështu, ndjekësit e traditës së tij janë njerëz falënderues ndaj All'llahut. Në Kur'an thuhet: **"Ne të kemi shpallur ty shpallje nga ana Jonë. Ti nuk e ke ditur çka është Libri, as besimi, por Ne e kemi bërë atë të ndritshëm, me të cilin udhëzojmë robtë tanë që dëshirojnë. Kurse ti (O Muhammed), pa dyshim, udhëzon në rrugë të drejtë."** (Esh Shura, 52) **"Ne të kemi dërguar ty (O Muhammed) për tërë njerëzit që t'u sjellësh lajme të gëzuara dhe t'u tërheqësh vërejtjen..."** (Es Sebe, 28)

Këto ajete shprehin thellësisht dashurinë dhe respektin ndaj figurës së Profetit të Islamit, që aq shumë myslimanë nëpër botë e admirojnë duke ndjekur synnetin e tij.

Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi Profetin Muhammed që solli mëshirë për të gjithë njerëzit, gjithashtu, paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi familjen, shokët e tij dhe të gjithë ata që ndjekin rrugën e tij.

Profeti i nderuar rrezatoi gjithë botën me shembullin e tij, me sjelljen, mëshirën, dashurinë për njerëzit, dhembshurinë e përlësinë ndaj Zotit të Madhëruar.

Është vërtet një mrekulli të shohësh se sa miliona myslimanë nëpër botë e admirojnë figurën e tij. Kjo ndjenjë e lartë për Profetin e dashur bazohet në ndikimin aq të madh që ka pasur ai në historinë e shoqërisë njerëzore. Ai përdori gjithë dhuntinë profetike në shërbim të njerëzimit, në shërimin e zemrave të sëmura, në plotësimin dhe përforsimin e idealit islam, pra, në të qenit një mysliman i vërtetë. Profeti (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) është simbol i paqes shpirtërore, i pastërtisë së karakterit njerëzor, i dashurisë, i besimit në një Zot, i ngritjes së vlerave morale dhe sociale, paqedashës e i përlur. Ai, duke e vendosur veten në një plan me profetët paraardhës ua imponoi njerëzve respektin dhe dashurinë për të gjithë ata.

Duke pasur parasysh se Islami bazohet në dy momente kyçe: ardhja e të Dërguarit dhe zbritja e Librit të Shenjtë (Kur'anit), vlen të theksohet rëndësia e "mesazhit", e pikërisht këtu njerëzit janë ndikuar duke gjetur strehim në zbatimin e fesë Islame dhe në shembullin e Profetit të nderuar. Ai, me aftësinë e tij arriti të pranohej deri tek njeriu i degraduar, mashtruesi, hipokriti, ateisti etj. duke sjellë **"dritën"** që u kishte munguar.

**I urojmë të gjithë myslimanëve
Gëzuar Ditëlindjen e Profetit Muhammed!
(paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!).
Kryeredaktorja**

KUR'ANI

Libri i Urtësisë

Adhurimi islam dhe mënyra islame e jetesës

Sipas Kur'anit të Shenjtë, qëllimi që Zoti e ka krijuar njeriun është ibadeti, domethënë, adhurimi. Duke adhuruar Zotin, njeriu mund ta trashëgojë Tokën si "Khalifatul – Lah", domethënë, si "zëvendës" i Zotit. **Ibadet** nuk do të thotë **adhurim** vetëm në kuptimin e ngushtë – falje (namazi) dhe lavdërimi i Zotit. Adhurim është çdo lloj sjelljeje njerëzore dhe çdo lloj shqetësimi njerëzor, qoftë ai mendor ose fizik, që shoqërohet me njohjen e Zotit dhe bëhet në pajtim me parimet dhe udhëheqësinë e Zotit, parashtruar në Kur'an dhe në Syntin e të Dërguarit të All'lahut, Profetit Muhammed (paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të!).

Kështu, asgjë nuk mund të quhet laike në jetën e myslimanit, sepse çdo aspekt i jetës së tij rregullohet nga Sheriati, domethënë, nga Kodi Islam i Sjelljes, mbështetur në Kur'an dhe në Syntin e Profetit Muhammed (paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të!). Atëherë, në qoftë se një mysliman i përmbahet fjalëve dhe shpirtit të Sheriatit në çdo veprim të tij – në politikë, në çështje tregtare dhe ekonomike ose në marrëdhëniet e tij me prindërit, farefisin,

miqtë dhe me të gjithë ata me të cilët ka të bëjë – me të vërtetë, ky veprim është ibadet. Kështu, për njeriun, thelbi i ibadetit në Islam është ta njohësh ekzistencën e Zotit dhe që këtej, gatishmëria e ndërgjegjshme për të vepruar gjithnjë sipas vullnetit dhe caktimit të All'lahut.

Dhe, është pikërisht ky koncepti i dyfishtë i njohjes dhe i gatishmërisë që jep kuptimin më



të thellë të adhurimit (ibadetit) në Kur'an. Me këtë mënyrë adhurimi, njeriu e zotëron Tokën si "zëvendës" i Zotit. Kjo tregon, gjithashtu, epërsinë e njeriut në Tokë e që gjithçka që është në Tokë, Zoti e ka bërë të dobishme për njeriun.

Mall dhe dashuri për Profetin

(paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të!)

Fllad pranveror... stinë zgjimi... zgjim nga gjumi i thellë dimëror. Toka nis të vishet me fustanin e saj shumëngjyrësh. Pemët papritmas mbulohen me gjethe e lule të cilat i japin një bukuri madhështore natyrës. Akoma më e këndshme bëhet kjo bukuri kur brenda saj nis këngën bilbili. Vërtet, pranvera është stinë magjepsëse. Pas saj dashurohet çdokush, sipas perceptimit dhe mundësisë. Ka edhe nga ata që dashurohen gjithë jetën pas saj,

duke dashur që i gjithë viti të jetë pranverë; nuk kanë të ngopur me të. Janë të mahnitur pas bukurisë dhe mistereve që ajo fsheh. Mbase kanë të drejtë, mbase... Ndoshta edhe unë jam si ata, jam e dashuruar më të. S'e di! Por, di që vërtet jam e dashuruar pas bukurisë dhe sekreteve që mbart. E si të mos jem e dashuruar kur ajo mbart në vetvete ditën në të cilën ndriçoi bota?! Ah... pranverë sa të dua! Të dua më shumë se trangu i hurmës, i cili kërkoi të groposej nga dashuria që kishte për Profetin (paqja dhe

bekimet e All'lahut qofshin mbi të!). A ke dëgjuar ti për dialogun e bukur dhe emocionues ndërmjet Profetit (paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të!) dhe trangu të hurmës? Profeti Muhammed zbriti nga minberi dhe duke e fërkuar trangu e hurmës me duart e tij të bekuara, e pyeti: "O druri i hurmës ç'kërkon? Pse qan?" Dhe druri i hurmës nisi të fliste me gjuhën e vet. Mes lotëve të nxehtë, iu përgjigj: "Dëshira ime e vetme është të shkrihem e të humb në qenien



tënde! Prandaj, më merr e më gropos që të kalbëm, të humb e të shpëtoj nga ky trup i vdekshëm!..." Nga kjo ngjarje e mrekullueshme të duket sikur zemra të flet me gjuhën e trungut të hurmës, e Resulull'lahi (paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të!) të fërkon me dorën e tij. Ia kam zili trungut të Hurmës. Ia kam zili për dashurinë ndaj Profetit (paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të!). Unë apo trungu i Hurmës, kush e do më shumë të Dërguarin e All'lahut? Ndërkohë që përpiqem të qetësoj veten, mendja më shkon më tej. Më kujtohet tashmë edhe ai dialogu i këndshëm ndërmjet Hz. Fatimesë dhe Hz. Aliut. Një herë, Hz. Fatimeja dhe Hz. Aliu po bisedonin dhe i bënë komplimente njëri-tjetrit. Me një qeshje të ëmbël, pyesin njëri-tjetrin: "Cili është më i dashur tek i Dërguari i All'lahut, bija apo dhëndrri?" Në atë kohë, erdhi i Dërguari i All'lahut dhe kur i pa të gëzuar, u gëzua edhe ai (paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të!). E dashuruar shumë pas babait të saj, Hz. Fatimeja duke buzëqeshur i tha të Dërguarit të All'lahut: "Babai im i dashur, unë dhe Aliu ishim duke biseduar se cili nga ne është më i dashur tek ju, unë apo ai?" Profeti i mëshirës, për ta shfaqur dashurinë që kishte për vajzën dhe dhëndrrin e tij iu përgjigj: "Vajza ime, ti je më e dashur se Aliu në aspektin e dashurisë natyrore që ka babai për fëmijën e tij, por Aliu është më i rëndësishëm dhe më fisnik në syrin tim." Kështu, ai shprehu faktin se i donte të dy në aspekte dhe pikëpamje të ndryshme. Nuk ka se si të ndodhë ndryshe. Dashuria për Profetin të çon në dashurinë për All'lahun. Fatlum është ai njeri që meriton dashurinë e Profetit dhe dashurohet pas tij. Ai është boshti i botës. Është vatra e jetës sonë. Ngado që shkojmë dhe kthehemi, ai është pika ku do të kthehemi sërish. Është klima ku do të gjejmë ngushëllim. Është udhëzuesi që do ndjekim. Ai është



dhuratë

e All'lahut për Gjithësinë. T e k ai gjejmë idealet që i përkasin njeriut të përsosur. Gjejmë bujarinë, dashurinë, dhembshurinë, guximin, sinqeritetin, maturinë, durimin, miqësinë, butësinë etj. Gjejmë atë që thotë All'lahu në Kur'an: "Ai (Muhammedi) është mëshirë për botët". E mëshira për njeriun fillon atëherë kur fillon lulëzimi. Mëshira e botëve lulëzoi në një ditë të bukur prilli. Prandaj, unë e dua stinën e pranverës; e dashuroj atë. Për mua kjo stinë mbart kurorën e artë, mbart fillade mëshire, dashurie e urtësie; mbart në gjirin e saj pedestalin e mirësisë, lotët e nxehtë të trungut të hurmës, mbart me vete dashurinë time për krijesën më të dashur të All'lahut. Duaje dhe ki mall edhe ti. Duaje ndriçuesin e botëve, Profetin Muhammed. Mundohu dhe bashkangjijtju karvanit të tij. Dërgoji përshëndetjet dhe salavatet e tua bashkë me All'lahun dhe melekët. Eja ti lutemi All'lahut së bashku që të na bëjë prej të dashurve të tij. Amin!

Përgatiti: Vjollca Feza



A e dini se...?

- Prej emrave të Ditës së Gjykimit që përmendet në Kur'an është Ahireti.

A e dini se...?

- Prej emrave të Ditës së Gjykimit që përmendet në Kur'an është El-Hakkatu.

A e dini se...?

- Prej emrave të Ditës së Gjykimit që përmendet në Kur'an është Radifetu.

A e dini se...?

- Prej emrave të Ditës së Gjykimit që përmendet në Kur'an është Es-Saatu.

A e dini se...?

- Prej emrave të Ditës së Gjykimit që përmendet në Kur'an është El-Gashije.

A e dini se...?

- Prej emrave të Ditës së Gjykimit që përmendet në Kur'an është Medd.

A e dini se...?

- Prej emrave të Ditës së Gjykimit që përmendet në Kur'an është El-Vakiatu.

A e dini se...?

- Prej emrave të Ditës së Gjykimit që përmendet në Kur'an është Jeumul Ba'athi.

A e dini se...?

- Prej emrave të Ditës së Gjykimit që përmendet në Kur'an është Jeume Tegabun.

A e dini se...?

- Prej emrave të Ditës së Gjykimit që përmendet në Kur'an është Jeums Sinadi.

A e dini se...?

- Prej emrave të Ditës së Gjykimit që përmendet në Kur'an është Jeumun Hadid.

A e dini se...?

- Prej emrave të Ditës së Gjykimit që përmendet në Kur'an është Jeumul Hashri.

A e dini se...?

- Prej emrave të Ditës së Gjykimit që përmendet në Kur'an është Jeumud Din.

A e dini se...?


- Prej emrave të Ditës së Gjykimit që përmendet në Kur'an është Jeumul Khuraxhi.

A e dini se...?

- Prej emrave të Ditës së Gjykimit që përmendet në Kur'an është Jeumun Adhim.

A e dini se...?

- Prej emrave të Ditës së Gjykimit që përmendet në Kur'an është Jeumul Fet'hi.



Emrat e bukur të Zotit

jeton në paqe me veten, me njerëzit e tjerë, me Gjithësinë dhe me Zotin e tij: "Vërtet, që ju ka ardhur nga All'Ilahu një Dritë dhe një Libër i qartë, me anë të të cilit, All'Ilahu udhëheq të gjithë ata të cilët kërkojnë kënaqësinë e Tij drejt rrugëve të paqes dhe Ai i nxjerr ata nga errësira në dritë." (El Maide: 15-16)

Besimtarët përhapin paqe ndërmjet njeri-tjetrit dhe kudo në botë. Muhammedi (paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të!) ka thënë: "Pasha Atë, në dorën e të Cilit, është shpirti im, nuk do të hyni në Xhennet derisa të besoni dhe ju nuk do të besoni derisa nuk e doni njeri-tjetrin. A t'ju tregoj diçka për të bërë, në mënyrë që ta doni njeri-tjetrin? Përhapeni selamin (paqen) në mesin tuaj." (Muslimi)

"O Zoti im! Ti je Paqedhënësi dhe paqja është nga Ti; i Bekuar qofsh Ti, o Pronar i Madhështisë dhe i Bujarisë!" (Muslimi)

"Thuaj: 'I mbështetem Zotit të agimit nga sherri i asaj që Ai ka krijuar.'" (El Felek: 1-2)

Bëni paqe me çfarëdo çmimi.

Es-Selam (Paqedhënësi)

"Ai është All'Ilahu, që nuk ka zot tjetër, përveç Tij, Sunduesi, i Shenjti, Paqedhënësi." (El Hashr: 23)

Paqja e vërtetë në këtë jetë ju vjen atyre që e njohin dhe i shërbejnë All'Ilahut. "Thuaj: 'Gjithë lavdërimet dhe falënderimet qofshin për All'Ilahun dhe paqja qoftë mbi robtë e Tij, të cilët Ai i ka zgjedhur.'" (En Neml: 59) Dhe në Jetën e Ardhshme, "përshëndetja e tyre, ditën që do ta takojnë Atë, do të jetë paqe!" (El Ahzab: 44)

Në kohëra të frikës, shqetësimit dhe vështirësisë, besimtari gjen paqe me All'Ilahun. "Thuaj: 'I mbështetem Zotit të agimit nga sherri i asaj që Ai ka krijuar.'" (El Felek: 1-2)

Besimtari duke pasur vullnetin e All'Ilahut,

ALL'LLAHU

PROFETËT

NJERËZIT

Ky trekëndësh i ngritur në lidhjen trefishe tregon raportin e **mishërimit të madh me botën qiellore – tokësore** dhe atë të Ahiretit. Meqë në çdo rast e në çdo përkufizim të idesë për realitetin objektiv është përcaktuar raporti i qëndrimit të njëri – tjetrit është krijuar edhe domethënia e sures **Fatiha** në Mekë:


“Lavdërimi është për All’llahun, Zotin e botëve.”

Në këtë lidhje të tillë, kur profetët kanë krijuar mishërimet shpirtërore dhe mrekullitë, i kanë zbatuar sipas urdhrit ashtu të përlur përpara të të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit. I tillë ishte Miraxhi i Profetit Muhammed (paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të!). Ata, çdo herë, me modesti kanë pritur të marrin urdhra të zbatojnë nismën e tyre, por, gjithmonë në emër të All’llahut u përpoqën ta përcjellin me bindje dhe urti tek njeriu.

Ka ngjarë dhe ngjan, çdo herë, në mesin e njerëzve të përvidhet prapësia. Duke i shkëlqyer rrugët e mashtrimit, njeriu është nisur me bindje të plotë

se është vetë i plotfuqishëm! Dhe në atë rropatje është larguar edhe nga Profetët, edhe nga All’llahu. Edhe sot e kësaj dite, sa e sa herë për hir të një fitimi personal ose për hir të marketingut të interesit politik, sa e sa shoqëri, parti, organizata, akademi shkencash lejojnë teza joracionale, përpilojnë programe e propaganda të tepruara vetëm e vetëm që të ndezin në damarin e gjakut të njeriut dhe në arsyen e të menduarit të tij demonët e shterpësive.

Mësimi i Kur’anit qëndron në lidhjen trefishe ku raporti i të Gjithëfuqishmit, Mëshirëplotit, çdo herë, qëndron nga anësia, por, në përgjithësi, di, shikon, dëgjon. Megjithatë, urdhrin e Tij e zbatojnë profetët: **“Si mund ta mohoni All’llahun ju që keni qenë të vdekur dhe ju ka ngjallur, pastaj ju vdes dhe prapë ju ringjallë dhe mandej te Ai do të ktheheni?”** (El - Bekare, 28). Ndërsa në ajetin 29 të po kësaj sureje lexojmë: **“Ai është All’llahu që ka krijuar për ju gjithçka që ka në tokë, pastaj**



vullnetin e Tij e ka drejtuar kah qielli dhe i rregulloi shtatë qiej. Ai për çdo send ka dijeni.” Në këtë kuptim, urdhrat e profetëve kanë vetëm forcën, por, hyjnë në zbatim përmes shëmbëlltyrave e mrekullive të tyre të përsosura si në sjellje, në gjykim dhe në qëndrim.

Sa e sa herë është vënë pozita e tyre ndërmjet moralit dhe imoralitetit, por kurrë s’janë rrëmbyer nga udhët e paudha. Sa e sa herë ka mundur të plasë sherri për ndonjë ndodhi për hir të gjykimit. Sa e sa herë do ta kishin pësuar ose do të ishin shkatërruar shpirtërisht e moralisht vetë njerëzit ndër breza! Sa e sa herë një qëndrim i tyre do të shmangte rastet e vlerave të Islamit për hir të paqartësisë. Prandaj, me një vetëmohim të lartë, ata në çdo vend e në çdo kohë e përfillën, zbatuan dhe e shfaqën atë që ishte marrë si vendim nga i Gjithëmëshirshmi, Mëshiruesi, Fuqiploti – All’llah.

Sot, kur ndeshemi me përballje të ndryshme të situatave, sa herë ngjan që për qëndrime të njëanshme, për gjykime jo të pjekura, për hir të shkallës së ulët të moralit shpirtëror të botëkuptimit fetar tek njerëzit paraqitet arrogancë. Mbase kjo vë edhe në përballje popujt që vijnë deri te përplasjet, konfrontimet, gjakderdhjet, siç ndodh në shumë raste në historinë njerëzore. Vallë! Çfarë do të bëhet me robtë tanë? Kjo vlen të përmbyllet se ai që prin, kurrë nuk shikon se çka do të flirtojë nga shpirti i tij, sepse shpirti, zemra dhe trupi i tij i mishëruar thellë me lidhjen e ashtuquajtur: All’llahu – Profetët – Njerëzit, kërkuan për të gjithë shpëtim ...!

Përgatiti: Ferit Ramadani



Xhujberi



dhe Zelfa



I Dërguari i Zotit (paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të!), ka thënë: ***"Mirësia ndaj gruas është mbarësia e fejesës dhe e prikës së saj."***

- "Sa mirë do të ishte sikur të marthoheshë, të krijoje familje e t'i jepje fund vetmisë sepse jo vetëm që ke nevojë për grua por, gjithashtu, gruaja të ndihmon si në punët e kësaj jete ashtu edhe të Jetës Tjetër."

- "O i Dërguar i Zotit, unë nuk kam as mall dhe as bukuri, jam njeri pa njeri, e kush më jep grua mua; e kush vallë është ajo grua që dëshiron të bëhet bashkëshorte e një burri të varfër, shtatshkurtër, të zi dhe të shëmtuar si unë?!"

- "O Xhujber, Zoti nëpërmjet Islamit i ka ndërruar vlerat e njerëzve. Shumë prej atyre që kanë qenë të respektuar në periudhën e injorancës, feja i ka bërë që të bien poshtë. Mjaft njerëz në kohën e injorancës ishin të poshtëruar dhe pa ndonjë vlerë, ndërsa Islami ua ngriti atyre vlerat dhe pozitën. Zoti, nëpërmjet Islamit i fshiu mendjemadhësinë, injorancën dhe krenarinë që lidhej me racën dhe me familjen. Tashmë, të gjithë njerëzit, si të bardhë ashtu edhe të zinj, kurejshë e jokurejshë, arabë dhe joarabë janë në një shkallë. Askush nuk ka përparësi ndaj



tjetrit, veçse nëpërmjet devotshmërisë dhe adhurimit. Unë në mesin e myslimanëve shikoj më lart se ty vetëm atë njeri, i cili është më i devotshëm dhe më i ditur se ty. Tani bëj si të të urdhëroj unë."

Këto ishin disa fjalë që u shkëmbyen mes Profetit të nderuar (paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të!) dhe Xhujberit, një ditë kur Profeti kishte ardhur për të takuar

“Shokët e Sufesë”. Xhujberi ishte nga ana e Jumamesë. Ai kishte qenë atje kur kishte dëgjuar për Islamin bashkë me ardhjen e Profetit të fundit. Ai, sado që ishte i vobektë, i zi dhe shtatshkurtër, prapëseprapë, ishte i zgjuar, kërkues i së vërtetës dhe njeri me vullnet. Pasi dëgjoji zërin e *Islamit*, erdhi

dhe jetesën e tyre. Një ditë, i Dërguari i Zotit shkoi për t’i takuar ata. Në mes të të gjithëve i zunë sytë Xhujberin dhe mendoi që ta nxirrte atë nga kjo situatë dhe t’i jepte zgjidhje jetës së tij. Mirëpo, gjëja e vetme, e cila nuk i shkonte kurrë ndërmend Xhujberit, duke patur parasysh gjendjen e tij ishte



menjëherë në Medine që të shikonte më nga afër rrjedhën e ngjarjeve. Nuk kaloi shumë kohë dhe pranoi Islamin e u bashkua me myslimanët; mirëpo, për shkak se nuk kishte as para, as shtëpi dhe as të njohur, me urdhër të Profetit qëndroi përkohësisht në xhami. Pak nga pak, në mesin e personave të tjerë që u bënë myslimanë dhe që qëndronin në Medine u gjendën persona të tjerë, të cilët, sikurse edhe Xhujberi ishin të varfër dhe të mjerë. Me urdhër të Profetit edhe këta vendoseshin në xhami, derisa i erdhi shpallja Profetit që xhamia nuk ishte vendbanim dhe këta duhej që të bënë shtëpi poshtë xhamisë. Profeti caktoi një vend jashtë xhamisë dhe ngriti atje një strehë të madhe kundra diellit dhe i vendosi ata tek ajo strehë. Atë vend e quanin “Sufe”, ndërsa banorët e saj, të cilët ishin si të varfër ashtu edhe të huaj quheshin “Shokët e Sufesë.” I Dërguari i Zotit dhe shokët e tij kujdeseshin për gjendjen

kjo, që ai një ditë do të kishte grua, shtëpi dhe gjërat elementare të jetesës. Kjo ishte arsyeja që kur i Dërguari i Zotit i propozoi atij që të martohej, ai me habi iu përgjigj: “Vallë, a mundet ndokush të pranojë e të martohet me mua?!” Mirëpo, Profeti e nxori menjëherë atë prej gabimit të tij duke e vënë në dijeni mbi përparimin e gjendjes shoqërore si rrjedhojë e ardhjes së fesë islame. Profeti,, pasi e nxori Xhujberin prej gabimit dhe e bëri të sigurt dhe optimist për jetën, i dha urdhër që të shkonte menjëherë tek shtëpia e Zijad ibn Labid Ensarit dhe të kërkonte dorën e së bijës, Zelfës për martesë. Zijad ibn Labidi ishte prej njerëzve më të pasur dhe më të respektuar të Medines. Fisi i tij e respektonte shumë. Kur hyri Xhujberi në shtëpinë e Zijadit pa që ishin mbledhur shumë prej të afërmeve dhe prej të fisit të Lebidëve. Xhujberi, pasi u ul, heshti për pak kohë dhe pastaj ngriti kokën dhe i tha Zijadit: “Unë kam një lajm nga

ana e Profetit për ju, a të flasim veçmas apo ta them hapur?”

- “Lajmi i Profetit është nder për mua, sigurisht që ta thuash haptazi.”
- “Profeti më ka dërguar që të të kërkoj dorën e vajzës tënde, Zelfës.”
- “Profeti vetë ta ka thënë ty këtë gjë?!”
- “Unë nuk flas nga vetja, të gjithë më njohin



dhe e dinë se nuk jam gënjeshtar.”

- “Është e habitshme, ne nuk e kemi për zakon që t’ia japim vajzën dikujt tjetër, përveç atyre të rangut tonë. Ti shko, unë do të shkoj e ta takoj vetë Profetin dhe do të bisedoj vetë me të për këtë çështje.”
- Xhujberi u ngrit nga vendi dhe doli nga shtëpia e ashtu duke ecur thoshte me vete: “Pasha Zotin, ajo çka na mëson Kur’ani dhe ajo për çka është profetësia e Muhammedit është tjetër gjë me atë që thotë Zijadi.” Kushdo që i kalonte pranë, i dëgjonte fjalët që pëshpëriste Xhujberi me vete. Zelfa, e bija e Labidit, e cila ishte e njohur për bukurinë e saj, i dëgjoi fjalët e Xhujberit dhe shkoi pranë të atit që të mësonte se si qëndronte puna. “O baba, ky njeri që sapo doli nga shtëpia, çfarë po pëshpëriste me vete dhe çfarë qëllimi kishte?”

- “Ky burrë erdhi të kërkonte dorën tënde dhe pretendonte se e kishte dërguar Profeti.”

- “Po sikur atë ta ketë dërguar me të vërtetë Profeti, atëherë mospranimi konsiderohet mosbindje ndaj urdhrit të tij.”
- “Ti i beson? Si duhet të bëj?”

- “Unë besoj se duhet ta kthejmë shpejt atë në shtëpi përpara se ai të mbërrijë tek Profeti dhe shko vetë tek Profeti dhe zbulo të vërtetën...”

... Zijadi e ktheu Xhujberin me respekt në shtëpi dhe nxitoi vetë për te Profeti. Sapo e pa atë tha:

- “O i Dërguar i Zotit, Xhujberi erdhi në shtëpinë tonë dhe më solli të këtillë lajm prej jush. Traditat dhe zakonet tona në fuqi janë të këtilla që vajzat tona ua japim vetëm atyre që kanë pozitë të

njëjtë me ne dhe që janë prej fisit tonë, të cilët janë ensarët dhe shokët tuaj.”

Profeti (paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të!) tha: “O Zijad, Xhujberi është besimtar, ato pozita të cilat ty po ti merr mendja sot, janë zhdukur. Burri besimtar i përket pozitës së gruas besimtare.” Zijadi u kthye në shtëpi dhe shkoi përnjëherë tek e bija, Zelfa dhe i tregoi ngjarjen.

- “Për mendimin tim mos e refuzo propozimin e Profetit. Çështja më përket mua. Sido që të jetë Xhujberi, unë jam ajo që duhet të jem e kënaqur. Përderisa i Dërguari i Zotit është dakort me këtë punë edhe unë jam dakord.” – tha Zelfa.


Babai e martoi Zelfën me Xhujberin. E cakttoi mehrin e tij prej plaçkës së vet dhe i përgatiti pajë të mirë nuses. Xhujberin e pyetën:

- “A e ke marrë parasysht shtëpinë se ku do

ta fusësh nusen?"

- "Unë, e vetmja gjë për të cilën kurrë nuk kisha menduar, ishte se vallë do vinte ndonjëherë ndonjë ditë që unë të kisha grua dhe jetën time. Profeti erdhi papritur e më tha ashtu e kështu dhe më dërgoi mua në shtëpinë e Zijadit." Zijadi e përgatiti vetë shtëpinë dhe orenditë shtëpiake, plus dy veshje të përshtatshme për dhëndrin dhe e çoi nusen në atë shtëpi të zbukuruar, të parfumosur dhe të stolitur. U errësua dhe ra nata. Xhujberi nuk e dinte se ku gjendej shtëpia që ishte gatitur enkas për të. Xhujberin e shpunë në atë shtëpi. Sapo i panë sytë gjithë atë shtëpi, gjithë ato plaçka dhe atë nuse aq të bukur iu kujtua e kaluara. Mendoj me vete: "...Unë isha një njeri i varfër dhe i huaj kur hyra në këtë qytet dhe nuk kisha asgjë, as mall dhe as bukuri, as familje dhe as farefis. Zoti m'i bëri të mundura mua të gjitha këto mirësi. "Ja pra, ky është Islami që i ka dhënë kaq shumë ndryshim njerëzve që kurrë nuk ta mernte mendja. E pra, sa shumë duhet ta falënderojmë Zotin." Në atë çast atij i lindi një ndjenjë kënaqësie, mallëngjimi dhe falënderimi për Zotin e Lartësuar. Shkoi drejt e në një qoshe të dhomës dhe filloi të këndojë Kur'an dhe të falej. Ai erdhi në vete vetëm kur veshët i dëgjuan ezanin e namazit të sabahut. Atë ditë në shenjë falënderimi, Xhujberi vendosi ta agjëronte. Kur gratë shkuan të shihnin Zelfën, e gjetën atë të virgjër dhe të pa zënë me dorë. U bë e qartë se Xhujberi aspak si ishte afruar asaj. Këtë gjë e mbajtën të fshehtë për Zijadin. Kaluan edhe dy ditë dhe netë të tjera po në këtë mënyrë. Xhujberi ditën agjëronte, ndërsa natën falej dhe lexonte Kur'an. Pak nga pak te familja e nuses filloi të lindte mendimi se mos Xhujberi ishte i paafte

seksualisht dhe nuk kishte nevojë për femër. Të detyruar, i a treguan çështjen vetë Zijadit. Zijadi e



informoi

Profetin rreth çështjes. Profeti e thirri Xhujberin dhe i tha:

- "Vallë, tek ti nuk ekziston dëshira për grua?!"
- "Për fat, kjo dëshirë është shumë e ndezur tek unë."
- "Atëherë, përse nuk i je afruar nuses deri tani?"
- "O i Dërguar i Zotit, kur u futa në atë shtëpi e pashë veten në mes të gjithë atyre mirësive dhe rashë në mendime, se sa shumë dashamirësi ka treguar Zoti ndaj këtij robi kaq të vogël dhe të parëndësishëm, prandaj edhe mu zgjua dëshira për ta falënderuar dhe për t'ju falur Atij. E pashë të nevojshme se përpara çdo gjëje tjetër, të falënderoj dhe t'i falem Zotit tim. Që sonte do të shkoj pranë gruas sime." I Dërguari i Zotit i tregoi Zijadit thelbin e çështjes. Xhujberi dhe Zelfa u martuan dhe ia kalonin përsëmbari së bashku. Filloi një luftë e shenjtë. Xhujberi, me atë zellin dhe entuziasmin që është veçori e burrave besimtarë, mori pjesë në luftën e shenjtë nën flamurin e Islamit dhe ra dëshmor. Pas kësaj, asnjë gruaje tjetër nuk i kërkohej dora për martesë aq sa iu kërkonte Zelfës dhe për asnjë grua tjetër nuk ishin të gatshëm

Pikëpamja islame për krijimin

Çfarë thotë Kur'ani për krijimin e njeriut

Ligji i evolucionit, të cilin Europa pretendon ta ketë zbuluar, ishte përcaktuar në Kur'an 1400 vjet më parë. Njeriu nuk u krijua në një moment në formën që ai është sot. All'illahu nuk bëri një model prej balte dhe i dha jetë për t'u bërë njeriu i parë. Jo, njeriu ka arritur formën e tij të tanishme pasi ka kaluar nëpërmjet shumë fazave. Njeriu ka dalë nga dheu mbi këtë Tokë. All'illahu bëri të mundur që ju të dilni nga Toka.



Është dëshpërues fakti, se në ditët e sotme besimi mysliman ka humbur shikimin e dy pikave kryesore se krijimi dhe shfaqja e njeriut nuk ka ndodhur në një moment. Ai u krijua nga Toka dhe në Tokë. Kur'ani na tregon se krijimi i njeriut u bë në faza graduale dhe nënkuptohet që përmes këtij zhvillimi të ngadaltë do të eliminoheshin defektet në trupin dhe natyrën e tij. Injoranca e madhe e disa drejtuesve myslimanë mund të jepet si më poshtë: Një anëtar i dalluar i lëvizjes Almadiyya dhe shoqërues i Mesias tha se një nga mësuesit e tij, njëherë, kishte shpjeguar se një njeri mund të ishte krijuar i bukur, një tjetër i

shëmtuar dhe një tjetër mesatar.

Kjo kishte të bënte me faktin se kur All'illahu vendosi t'i krijonte njerëzit, Ai bëri një kontratë me melekët, të cilët, për ta përfunduar këtë punë duhet të bënin një kuotë të caktuar ditore.

Melekët filluan të rrihnin baltën mirë dhe t'i jepnin forma të bukura dhe të mira.

Ata punuan ngadalë pa u nxituar deri në mesditë pra, duke i kushtuar vëmendje çdo pjese. Pas një kohe të caktuar ata panë se po vonoheshin dhe nuk mund të plotësonin kuotën e caktuar, kështu, ata filluan të punonin më shpejt vetëm për të përfunduar punën e tyre.

Atëherë, ata nuk i kushtuan më vëmendje punës së tyre artistike dhe si rezultat qeniet e formuara në pjesën e parë të punës së tyre ishin shumë tërheqëse, kurse ato që u bënë në pjesën e parë të mbasdites ishin mesatare.

E meqë koha po kalonte, melekët vune re se ata ishin shumë vonë për të plotësuar kuotën ditore, kështu që nuk i kushtuan më vëmendje.

Me shpejtësi ata krijuan një figurë nga balta me një të prekur me gisht për të bërë gojë dhe me dy të prekura për të bërë sytë. Pa dyshim, këto dy figura nuk mund të krahasoheshin me ato të bëra gjatë paradites.



Keto shembuj tregojnë se si përmes injorancës besime të pajustificuara të myslimanëve, kristianëve dhe hebrenjëve e kanë kthyer të vërtetën në karikatura dëshpëruese dhe mite të rreme.

Faza e parë

Pika tjetër e shpallur në Kur'an në lidhje me krijimin e njeriut, ishte faza e parë - një gjendje jo ekzistuese. Një subjekt i diskutueshëm, mendimi i Arya Samajists është se lënda, nga e cila përbëhet universi është e përjetshme .

All'Ilahu nuk bëri gjë tjetër, përveçse realizoi një lidhje të ngushtë midis trupit dhe shpirtit. Kjo gjë kundërshtohet nga Kur'ani, i cili na mëson se materia nuk është e përjetshme, por është një krijim i All'Ilahut nga e cila u bë njeriu.

All'Ilahu thotë në Kur'anin e Shenjtë: *"A nuk e mban mend njeriu që Ne e krijuam atë më parë nga asgjëja. Lindja njerëzore bëhet nga fara e mashkullit."*

Kjo sure i referohet krijimit të parë origjinal të

specieve ose njeriut të parë.

Duhet të vihet re me kujdes se në Kur'an nuk thuhet që ekzistenca u krijua nga joekzistenca.

Aty thuhet se para fazës në të cilën materia dhe gjëra të tjera ekzistonin kishte një fazë tjetër ku nuk ekzistonte asgjë.

Ne themi se një karrige mund të bëhet nga një copë dru ose një zinxhir mund të bëhet nga një copë hekur; ne këtu kemi materien në një formë e cila mund të përdoret për të bërë diçka tjetër.

Shpesh, ateistët kundërshtojnë duke thënë se është e pamundur të bësh diçka nga asgjëja. Sidoqoftë, kjo nuk nënkuptohet në Kur'an, por ajo që kuptohet është se para krijimit të universit ekzistonte një periudhë në të cilën nuk kishte asgjë.

Më pas erdhi krijimi, si dhe, krijimi i njeriut. All'Ilahu nuk i ka dhënë njeriut dijen për ta kuptuar se si ndodhi; kjo ka mundësi të jetë

e pakapshme nga njeriu.
Nëse njeriu do ta dinte se si u krijua,
atëherë ai do të ishte i aftë të krijonte
vetveten.

Faza e dytë

Është shfaqur në Kur'anin e Shenjtë
se faza e dytë e krijimit të njeriut
ishte një gjendje ekzistence
kur trupi i njeriut ekzistonte, por
truri i tij, i cili e dallon njeriun nga
kafshët nuk ishte aktiv siç do të
bëhej më vonë.

Pra, si të themi ishte një trup njerëzor që
nuk ishte akoma një qenie njerëzore.
Me fjalë të tjera, ishte një trup njerëzor
pa trurin e perfeksionuar.

Ne nuk jemi në gjendje të themi nëse
ai ishte një formacion shkëmbor apo një
lloj bime. Sidoqoftë, mund të themi që nuk
ishte akoma një kafshë. Në Kur'an thuhet:
*"Ka qenë sigurisht, një kohë kur ai nuk ishte
diçka që të mund të fliste"*; me fjalë të
tjera, ka patur një periudhë të njerëzimit kur
ai nuk ishte i vetëdijshëm për ekzistencën e
tij dhe se nuk ishte i aftë të njihte vetveten.


Faza e tretë

Faza e tretë në evolucionin e njeriut u arrit
kur u bë i mundur shumimi i specieve të
tjera nisur nga fara e mashkullit e mbjellë
në trupin e femrës në saje të marrëdhënies
seksuale. Nga ky këndvështrim, më tej
ndeshet shumica e temperamenteve
njerëzore.

Faza e katërt

Faza e katërt erdhi kur truri arriti në perfeksion
dhe u karakterizua nga një formë e zhvilluar
dijeje dhe inteligjence.

Duke patur aftësinë e të dëgjuarit dhe të të
shikuarit, që janë cilësi që mund të gjenden
edhe te kafshët, ai u bë i aftë të ushtronte
inteligjencën e tij deri në një pikë ku përmes



n j ë
erdhënnjë
dhe aftësish

shpirti kërkues
sërë shpikjesh
mendore.

Këtu ai pati një hap më të lartë se
qeniet e tjera, një kafshë e aftë për të folur
dhe për të menduar.

Këto lidhje në zinxhirin e evoluimit të njeriut
janë lidhjet fillestare të fazave të ndryshme.
Periudhat midis shfaqjes së këtyre lidhjeve
nuk janë dhënë qartë në Kur'an. Kur'ani
u referohet këtyre çështjeve të cilat ishin
të domosdoshme për të sjellë të vërtetën
duke iu lënë njerëzve vend për mbushjen
e hapësirave.

*"All'lahu ju krijoi juve nga pluhuri, më pas
nga një pikëz fare e më pas ju bëri çift."*

Kur u zhvillua mendja njerëzore, dolën
temperamente të ndryshme, individët
filluan të dalloheshin nga njëri-tjetri. Kjo
çoi në formimin e grupeve sociale si për
shembull familjen ose kombinime të
individëve të caktuar. Evoluimi i njeriut
mund të përmblihet duke thënë se në
fillim njeriu ishte vetëm një grimcë dheu
ose një lloj formacioni shkëmbor. Pas disa
fazave të caktuara, jo të përmendura në
Kur'an, njeriu arriti në një fazë dhe u nda
në mashkull dhe në femër të krijuar nga
marrëdhëniet e mashkullit dhe të femrës.

Nuk përmenden në Kur'an edhe disa faza ku njeriu bëhet një qenie sociale dhe ndahet në disa grupe dhe si rezultat i të cilave dolën disa ndarje fizike, ekonomike dhe mendore. Nga kjo pikë fillon historia e qënieve njerëzore.

Midis fazave të evolucionit të njeriut mund të përmendim atë kur uji u bashkua me dheun ose substancën shkëmbore. Ky bashkim i ujit me dheun e thatë që rezultoi në krijimin e një qenieje është përmendur në Kur'an.

"Ne e bëmë çdo qenie njerëzore nga uji." (21:31)

"Ai që ka bërë çdo gjë perfekte, Ai e ka krijuar dhe Ai e filloi krijimin e njeriut nga balta." (32:8)



Fjala arabe për baltën është (teen-i njomë) që do të thotë **dhe i përzier me ujë** që bëhet ngjitës. Sipas Kur'anit, jeta njerëzore e ka origjinën nga një substancë që është një përzierje e Tokës me ujin e me kalimin e kohës u bë njeri. Në suret e Kur'anit, thuhet se një fazë fillestare e evolucionit të njeriut ishte kur iu dha një formë e veçantë nga balta dhe kjo u ndoq nga një fazë tjetër, kur njeriu filloi të ngjizet nga marrëdhëniet seksuale të mashkullit dhe të femrës. Në Kur'anin e Shenjtë thuhet: "...dhe, më pas Ai i krijoi pasardhësit e Tij nga një ekstrakt i një lëngu të thjeshtë." (32:9)

"A nuk ju krijuam Ne nga një lëng i thjeshtë dhe më pas e vumë në një vend të sigurt?" (72:22). Këto vargje tregojnë qartë që origjina e njeriut nga Toka ishte një fazë nga e cila hap pas hapi erdhën faza të tjera ku ishte e përzier me ujë duke shkaktuar zhvillimin e një forme themelore të jetës e cila më vonë filloi të zhvillohej me funksionimin e oganeve seksuale tek femra dhe tek mashkulli. Të gjitha këto faza përfaqësojnë periudha të ndryshme, kohëzgjatja e të cilave, thjesht mund të imagjinohet. Kur'ani i Shenjtë përmend një parim themelor për krijimin e njeriut: "...dhe Ai jep gjykimin përfundimtar, Ai i bën njerëzit të qeshin e të qajnë, është Ai që vendos jetën dhe vdekjen. Ai krijon çiftet, mashkullin dhe femrën nga lëshimi i farës së mashkullit dhe vetëm Ai mund të sjellë një tjetër krijim." (53:43-48).

Përfundime: Nga suret e Kur'anit që u cituan dalin përfundimet e mëposhtme:

- Materiali, nga i cili u krijua njeriu, nuk është i përjetshëm. Ai u krijua nga Zoti.
- Krijimi i njeriut përfshiu një proces evoluimi, i cili u zgjerua gjatë një periudhe të gjatë kohe. Njeriu nuk u krijua vetëm në një moment.
- Njeriu u krijua nga origjina e specieve të tij. Nuk është e saktë që ai rrjedh nga specia e majmunit që është një teori e zhvilluar nga Darvini.
- Një nga fazat e evoluimit, në të cilën ai kaloi është diçka e ngjashme me gurin ose shkëmbin.
- Më pas, ai kaloi në një fazë të jetës si kafshë ku inteligjenca nuk ishte zhvilluar akoma, megjithëse, hante, pinte, lëvizte si kafshët e tjera.
- Më pas, ai u bë një qenie inteligjente, e aftë për të folur e për të komunikuar.
- Në fazën e tij përfundimtare, ai pati një sistem jetese dhe filloi rrugën drejt civilizimit dhe kulturës. Në vend që të bënte jetën të veçuar, si kafshët e tjera, ai filloi të punonte bashkë me speciet e tjera të llojit të vet duke zhvilluar një sistem dhe ligj jetese.

Muhammedi Profet

Martesa me Hadixhen e lroi Muhammedin nga barra e mendimit për jetesë, meqë pasuria e saj ishte e madhe. Ai, sapo vajti në shtëpinë e së shoqes, mendoi të ndihmonte dhe xhaxhanë, Ebu Talibin. Prandaj, mori të riste Aliun, djalin e vogël të tij. Të dy e donin Aliun si djalin e tyre. Muhammedi tani kishte më shumë kohë për t'ju dedikuar jetës shpirtërore. Shkonte herë pas here dhe sillej rreth Qabes e shpeshherë çlodhej pranë saj. Mendonte se ajo ishte e para faltore e ndërtuar nga profeti Ibrahim për t'ju lutur Zotit të Vetëm dhe të Pashoq. Kur hidhte brenda sytë, shihte se ishte mbushur me më shumë se 100 idhuj rreshtuar njëri pas tjetrit që kishin sy e veshë të gadhendur, por nuk shihnin e nuk dëgjonin; kishin këmbë e duar, por nuk lëviznin. Muhammedi, atëherë, mendonte: "Janë të gabuar dhe gënjejnë! A kanë këta fuqi t'i japin njeriut jetë e fuqi të eci e të punojë, e vetë nuk mund të lëvizin nga vendi? Po atëherë, pse sillen e ju falen arabët atyre? Pse bëjnë fli e sakrifikojnë për ta? Janë me të vërtetë njerëz të gabuar dhe të paditur". Dëshpërohej tepër ngaqë shihte popullin e vet në këtë gjendje pa gjetur kurrë qetësi. Vetë ai nuk e pasonte popullin e vet se mendonte para

çdo veprimi, ndërsa ata nuk e lodhnin mendjen. Lutej Muhammedi, nga thellësia e shpirtit që populli i tij të kthehej nga ajo çmendësi, të kuptonte dhe të mësonte se Ai që i ka krijuar njerëzit, kafshët e bimët, qiellin e tokën, diellin, hënën, yjet e gjithçka që shohin sytë duhet të jetë në të gjitha pikëpamjet, medoemos më i Plotësuar nga krijesat e Tija. Nuk ishte vetëm kjo që e dëshpëronte Muhammedin dhe e bënte zemrën e tij të pikonte lot gjaku, por hidhërohej dhe zemërohej tepër kur shihte këtu-atje, që pinin verën si ujë e bëheshin krejt të çmendur. Punonin gjithfarë veprash të liga pa i vrarë dhe pa i ndëshkuar ndërgjegja, meqë shpirtat i kishin të vdekur sikur zotrat që besonin. Plaçkitnin dhe hanin pasuritë e jetimëve dhe të të vejave, jepnin të holla me fajde shumë të madhe. Morali kishte humbur ndër ta dhe kryet e vendit e kishte zënë imoraliteti. Shpirti i Muhammedit nuk gjente qetësi në këtë rreth, prandaj u largua pothuajse krejt prej tyre dhe e kalonte kohën në vetmi. Shkonte në Qabe dhe sillej rreth saj dhe pastaj kthehej në shtëpi duke iu lutur Zotit që ta udhëhiqte dhe t'i tregonte udhën e drejtë. Shpeshherë e linte shtëpinë dhe shkonte larg njerëzisë në malin e Mekës e zinte vend në një shpellë që quhej *Hira*; hidhërohej duke parë veprat e idhujtarëve dhe atje e filladiste shpirtin duke

menduar vetëm Zotin, Krijuesin e Gjithësisë. Shikonte me habi dhe admirim qiellin që natën hijeshohej nga yjet e nga hëna që me dritën e tyre praronin tokën. Shihnte që ditën dukej në kupë të tij dielli, që i lëshonte rrezet e tija në katër anët e botës; vërente male e kodrina, fusha e shkretëtira. Të gjitha këto mendonte se duhej të ishin krijuar nga një Zot i Madh, i Fuqishëm. Në këtë gjendje dhe i gjunjëzuar para bukurisë së natyrës, thoshte me vete: "S'ka dyshim se Krijuesi i këtyre është më i Plotësuar se krijesat e tija. S'ka dyshim se Zoti është më i Madhi!". I thelluar kështu në mendime, kalonte ditë e natë, kalonte javë dhe shpesh mbushte edhe muajin. Ushqimin e merrte me vete, e nganjëherë shoqërohej dhe prej gruas së tij, Hadixhes, në shpellën *Hira*.

Një ditë, në muajin Ramazan të vitit të dyzetë të jetës së Muhammedit, ndërsa ishte në shpellën *Hira* dhe e kishte zënë gjumi, zbriti një melek dhe e thirri: "O Muhammed!" U zgjua nga gjumi nga kjo e papritur. Meleku i tha: "Lexo!" Muhammedi u përgjigj: "Nuk di të lexoj."

Përsëriti edhe një herë meleku fjalën: "Lexo!" dhe mori të njëjtën përgjigje. Të tretën herë e shtrëngoi më tepër dhe i foli: "Lexo!"

Këtë here, Muhammedi pyeti: "Ç'të lexoj?"

Meleku iu përgjigj: "Lexo me emrin e All'lahut, që është Krijuesi i Gjithësisë. Njeriun Ai e krijoi, nga një pikë atë e formoi. Lexo se Zoti yt është më i Ndershmi, i Cili e mësoi njeriun për atë çka nuk e dinte."

Muhammedi i përsëriti mbas melekut këto fjalë dhe i mbajti në mend sikur t'ishin skalitur në tru. Meleku u largua. Muhammedi doli jashtë që ta

shihnte mirë kush ishte ai që i foli dhe dëgjoi një zë: "Unë jam Xhebraili, meleku i cili u zbrit Profetëve urdhrat e Zotit dhe ti je Profeti i zgjedhur për të udhëhequr njerëzimin në rrugën e mbarë e të vërtetë."

E zuri frika Muhammedin nga barra e rëndë që iu ngarkua; e zunë një palë ethe të rënda; filloi të dridhej si purteka, e u drejtua me të shpejtë nga shtëpia. Kur arriti me zë të tretur, i tha të shoqes: "Mbulomë! Mbulomë!" Hadixheja u habit nga gjendja e të shoqit, deshi ta pyeste ç'i kishte ngjarë, por duke e parë se nuk ishte i qetë, mendoi ta linte të çlodhej dhe pastaj ta pyeste. E mbuloi mirë dhe i ndenji pranë që t'ishte gati t'i përgjigjej çdo kërkesë të tij.



Behlul Nebashi

Shejh Suduku transmeton: "Një ditë, Muadh ibn Xhebel shkoi te Profeti i nderuar duke qarë. I dha salam dhe Profeti ia ktheu. Pastaj, Profeti e pyeti: "Çfarë të bën të qash kështu o Muadh?" Ai iu përgjigj: "O i

Dërguar i All'Ilahut! Tek dera është një i ri me një trup të dobët, ngjyrë të varfëri, por me fytyrë të mirë që qan për rininë e tij, që i ka humbur shpresat dhe kërkon që të takohet me ty." Profeti i tha: Fute brenda atë djalin dhe Muadhi ashtu veproi. Djali hyri

brenda, e përshëndeti Profetin me salam dhe e mori selamin. Profeti e pyeti: "Përse qan?" Ai iu përgjigj: "E si të mos qaj kur jam ngarkuar me gjynahe. Sikur All'Ilahu i Madhëruar të më gjykojë vetëm për disa nga ato, do të më dënojë duke më futur në zjarrin e Xhehenemit dhe nuk do të më falë asnjëherë." Profeti e pyeti: "A i ke bërë shok All'Ilahut në adhurim?" Ai iu përgjigj: "Kërkoj mbrojtje nga Zoti që të mos i bëj shok Atij. (d.m.th. jo) Sërish, Profeti e pyeti: "A ke vrarë njeri, gjë që është e ndaluar rreptësisht nga All'Ilahu?"

Ai tha: "Jo." Atëherë, Profeti i tha: "All'Ilahu Fuqiptotë t'i fal gabimet e tua, qofshin edhe sa malet e larta." Djali tha: "Por, ato janë më të mëdha se malet e larta."

Profeti: "All'Ilahu t'i fal gabimet qofshin më të mëdha se shtatë tokat, se detrat dhe rëra e tyre, pemët dhe çfarë ka mbi tokë nga krijesat."

Djali: "Gjynahet e mia janë



më të mëdha se shtatë tokat dhe detrat e rëra e tyre, pemët dhe çfarë ka mbi të nga krijesat.”

Profeti: “All’Ilahu t’i fal gabimet e tua, qofshin ato edhe më të rënda se qiejt dhe yjet dhe se Arshi dhe Froni i All’Ilahut.”

Djali: “Gabimet e mia janë më të mëdha se kaq.”

Profeti e vështroi me syrin e një të zemëruari dhe

i tha: “O djalë, gabimet e tua janë më të mëdha se Zoti yt?” Djali me një fytyrë prekëse tha: “Madhërimi është për Zotin, s’ka gjë më të madhe se Zoti im. Zoti im është më i Madhi, o i Dërguar i All’Ilahut.”

Profeti: “A i fal gabimet e mëdha tjetërkush, përveç Zotit të Madhëruar?”

Djali: “Jo, për All’Ilahun, o i Dërguar i Tij.”

Kështu, djali heshti deri sa Profeti iu drejtua dhe i tha: “A nuk po më tregon mua një nga gabimet e tua?” Ai i tha: “Po, do të të tregoj dhe filloi: ‘Unë për shtatë vjet grabisja në varreza, ku pasi njerëzit varroseshin, i nxirja dhe ua merrja qefinat. Një ditë vdiq një komshije e disa vajzave të Ensarëve. E varrosën dhe pastaj të afërmit e saj u larguan. Sapo erdhi nata unë shkova tek varri i saj. E hapa varrin dhe e nxora trupin e saj nga varri. Ia hoqa qefinin dhe e lashë të zhveshur buzë varrit të saj dhe u largova. Më erdhi shejtani i mallkuar dhe filloi të më përpëliste dhe më thoshte: A nuk e shikon barkun dhe trupin e saj të bardhë dhe kofshët e saj a nuk i shikon? Vazhdoi të më thoshte këto fjalë, derisa u ktheva tek varri i saj ku nuk e përmbajta veten dhe e përdora atë sikurse përdoret një femër (marrëdhënie intime) dhe pastaj e lashë në varrin e saj. Duke u larguar, pas meje dëgjoj një zë



që thoshte: ‘I mjeri ti o djalë, për vendin tënd në Ditën e Gjykimit. Do të qëndrojmë së bashku të zhveshur sikurse më le mua të zhveshur në mesin e varrezave kur më nxorre nga varri im, më hoqe qefinin e më bërë atë që deshe dhe më le të papastër deri në Ditën e Llogarisë. Mjerë rinia jote nga zjarri.’ Prandaj, tha djali, nuk mendoj se do të shijoj erën e Xhennetit. Çfarë duhet të bëj unë o i Dërguar i All’Ilahut?”

Profeti i tha: “Largohu nga unë o i shturur, kam frikë se mos digjem nga zjarri yt sepse, nuk ka gjë më të afërt me ty se sa zjarri.”

Profeti vazhdoi ta qortonte derisa ai u largua dhe i veshur me një rrobë të vjetër doli nga qyteti e shkoi në mal ku kërkoi falje me lutje. Duke shtrënguar fytyrën e tij me duar, djali thoshte: “O Zot ky është Behluli, robi Yt, të është dorëzuar Ty dhe Mëshirës Tënde sepse është i pafuqishëm. O Zot, Ti je Ai që më njeh mua me njohjen Tënde. O Zot, jam bërë gjynahqar dhe shkova te i Dërguari Yt i penduar dhe ai më përzuri dhe më shtoi mua frikën. Ty të lutem me Emrat e Tua të Mëdhenj dhe me Fuqinë Tënde që të mos e humb shpresën. O Zot, mos ma kthe lutjen time dhe mos më largo nga Mëshira Jote.” Këto fjalë ai vazhdoi t’i thoshte për dyzet ditë dhe netë duke qarë. Kur u plotësuan dyzet ditët dhe netët, ai ngriti duart nga

qielli dhe tha: "O Zot, çfarë bërë me hallin tim?" Nëse e pranove lutjen time dhe më ke falur gjynahet e mia, zbulojë këtë tek i Dërguari Yt. Nëse nuk i je përgjigjur lutjes time dhe nuk m'i ke falur gjynahet e mia, më përshpejto për në zjarr që të më djegë mua, ose më jep dënim në këtë botë që të më shkatërrojë dhe të më shpëtojë nga turpi në Ditën e Kijametit."

Me këtë rast, All'llahu zbriti tek i Dërguari



i Tij këto ajete, ku thotë: "Për ata që, kur bëjnë vepra të turpshme," që ka për qëllim imoralitetin "ose i bëjnë dëm vetes," duke bërë gabime apo gjynahe të mëdha, sikurse është dhe imoraliteti, zhvarrosja e të vdekurve, marrja e qefinit etj. "e kujtojnë All'llahun, i kërkojnë falje për gjynahet e tyre" dhe thotë: "Kijeni frikë All'llahun dhe shpejtoni në pendim" – "e kush i fal gjynahet përveç All'llahut?" All'llahu thotë: "Të ka ardhur rob i Im o Muhammed, i penduar dhe e ke përzënë, por, nga do të shkojë ai dhe ku do të përballet? Kujt do t'i lutet dhe kujt t'i kërkojë falje, përveç Meje?" Më pas, thuhet: "dhe nuk ngulmojnë me vetëdije në gabimet që kanë bërë." Thuhet: "Nuk bëjnë imoralitet dhe zhvarrosin dhe marrin qefinet. Pra, për këta do të ketë si shpërblim falje madhështore (të gjynaheve) nga ana

e Zotit të tyre dhe kopshte, nëpër të cilët rrjedhin lumenj dhe ku do të qëndrojnë përherë. Sa shpërblim i bukur është ky për ata që punojnë (vepra të bukura)!" ("Ali Imran", ajetet 135-136)

Kur i ka zbritur ky ajet Profetit, ai ka dalë duke e lexuar dhe duke buzëqeshur u ka thënë shokëve të tij: "Kush më tregon se ku është ai djali i ri i penduar?"

Muadhi i ka thënë: "O i Dërguar i All'llahut, jemi njoftuar se ai është në filan vend." Profeti, së bashku me shokët e tij, mori rrugën për tek ai mal dhe u ngjitën për të kërkuar djalin, derisa e gjetën. Ai, me duart e tij kishte kapur qafën dhe po qëndronte në këmbë mes të dy kodrave. I ishte nixirë fytyra dhe shterruar faqet nga të qarët dhe thoshte: "O Zoti im, e ke përsosur krijimin tim dhe fytyrën time, por mjerë ndjenjat se ku do të përfundojnë? A në zjarr do të më djegësh mua? A pranë Teje do më lejosh të banoj? O Zoti im, me të vërtetë, të mirat e Tua janë të shumta për mua, por i mjeri unë se ku do të

përfundoj në fundin tim. A për në Xhennet do të më dërgosh apo për në zjarr do më drejtosh? O Zoti im, gjynahet e mia janë më të mëdha se qiejt dhe toka, Arshi dhe froni Yt i Madhërueshëm. Mjerë vetja ime! A do të më falësh mua apo do të turpërohem me këto gjynahe Ditën e Kijametit?"

Ai vazhdonte të thoshte këto fjalë dhe qante aq shumë sa që e dëgjuan disa zogj dhe po qanin prej të qarës së tij."

I Dërguari i All'llahut e thirri. Ia hoqi duart nga qafa dhe ia pastroi dheun që kishte në kokë duke i thënë: "O Behlul, gëzohu se Zoti yt të ka larguar nga zjarri." Pastaj, Profeti u tha shokëve të tij: "Kështu fshihen gjynahet sikurse i fshiu Behluli dhe pastaj i lexoi atij çfarë i kishte zbritur All'llahu nga Kur'ani dhe e përgëzoi atë me Xhennet."



Erdhi çasti që të shkoj, s'di a kam dëshirë,
por më duhet të them lamtumirë.

Amanet o ju që po ju lë

Amanet o gjaku im
vuajtjet e vdekjes tani i shoh
në Ditën e Gjykimit nuk kam dyshim.

Amanet o të dashurit e mi,
kohën që keni shfrytëzoheni në mirësi,
se në shtratin e vdekjes në të cilin unë
jam,

s'mund të bëj asgjë dhe pse dëshirë kam.

Amanet për kohën që ju ka mbetur,
çdo perandor nën dhe është tretur,
edhe pse mbi tokë me krenari ka ecur,
vetëm veprat, asgjë s'i ka tretur.

Amanet, mirësia të jetë furnizimi juaj,
nëse doni nga All'Ilahu për t'ju shpëtuar.

Amanet po ju lë këto fjalë,
për ju që jeni ende gjallë.

Në vuajtjet e vdekjes tani jam dëshmitar
dhe me të vërtetë s'është shaka
kur ky çast shumë mundime ka.
Po në llogarinë e varrit që është më
llahtar?

Ah, që tani jam dëshmitar
në atë që në dynja lehtë e kisha marrë.
Ah sa do të doja një të mirë ta kisha në
peshoren e veprave,
mundësinë e kisha, por nuk e shfrytëzoja.
Tani nuk ka kthim në dynjanë e ëmbël,
që për të Ahiretin e harrova.

Ta duash Ahiretin është detyrim,
Ta mbushësh dynjanë plot me mirësi.
Por ne, në këtë botë shkaktojmë veç
shkatërrim
e në dhimbjen tonë kthehet çdo
padrejtësi.

Ah sikur ta kisha bërë vetëm një të mire,
të zvogëloja ndëshkimin që më pret në
kurriz.

E vetmja shpresë që mbetet është t'i
kërkoj Zotit mëshirë,
por si t'ja kërkoj, kur unë për Të nuk bëra
asnjë sakrificë?

Ah, sikur ta kisha bërë një sevap,
në tërbimin e Xhehenemit të më freskonte
pak.

Ah, sikur të keqes t'i isha shmangur,
para zjarrit tani qëndroj e shtangur,
por të mirat s'i veprova
dhe të keqes nuk iu largova.

Ah sikur dhe të bëhem e të thërrmohem,
pluhur i padukshëm në ajër të
shpërndahem.

Këtë botë po e lë me shumë mundime,
ah sikur të kisha një argument për vetën
time...

Amanet, o ju që po ju lë,
mundimet e vdekjes po ju tregoj
e mos thoni se nuk dinjt asgjë,
se e vërteta ndodhet atje ku unë po shkoj.
Kjo jetë është veç një grimcë që
mashton,

e në Ahiret mbetemi përgjithmonë.

Amanet All'Ilahun ta doni,
për të mirat që ju ka dhënë, Atë
falënderoni.

Këtë dynja me punë të mira ta mbushni,
për mëshirë All'Ilahun ta lusni.

Për All'Ilah, njëri-tjetrin ta doni e ta
ndihmoni,

që All'Ilahu ndihmë t'ju japë, atëherë kur
më shumë e doni.

Majlinda Ndreca



Magjistarë ishin ata që mohuan,
injorantë ishin ata që nuk donin të
mësonin.

Të diturit ishin ata që nuk pranuan të
vërtetën,
nuk pranuan atë që do të sillte
ndryshimin.

E quajtën veten të ditur,
por ata kurrë nuk ditën të krahasonin
botën që jetonin me botën e
ndryshimit.

Të diturit, magjistarët, injorantët
mohuan atë njeri që e quajtën **El Emin**
"Ty të besojmë sepse je më i Drejti
ndër të gjithë"

Kur erdhi Shpallja e Zotit, gjithçka
ndryshoi

Njerëzit treguan kush ishin në të vërtetë
Erdhi Muhammedi në mesin e tyre
për të thënë të vërtetën dhe për të
larguar të kotën

Të adhuroni vetëm All'Ilahun,
Krijuesin e Vetëm

Jo, nuk donin të besonin, iu shmangën
dhe jetuan vetëm duke adhuruar zotat
e tyre

që kurrë nuk të dëgjonin e kurrë nuk të
ndihmonin.

Kur'ani, libri që provoi profetësinë e tij
dhe hodhi poshtë akuzat e kota.

E kërcënuan kurejshët tek xhaxhai i tij
që kurrë nuk ia ktheu shpinën
nipit që donte dhe jepte jetën për
fenë e tij,

t'i vendosin diellin në dorën e djathtë,
hënën në dorën e majtë për të
mohuar

fenë që sipas tyre e ka trilluar,
ai kurrë nuk pranoi.

Jetoi me frikë, jo për ata që e
kërcënuan,

frika e tij ishte vetëm All'Ilahu,
Ndëshkuesi më i Drejtë

që jetonte në zemrën plot iman.

**Amarildo Roshi, nxënës në
Fondacionin e Kur'anit, Lushnjë**

Të njihemi me suret e Kur'anit

17	Isra	Mekase	11 ajete
	1533 fjalë	6460 shkronja	

mendjemadhësisë, gjakderdhjes, ngrënies së pasurisë së jetimëve dhe ngrënies në peshtë

- Përballim ndaj çfarëdo lloj kokëfortësie kundër së drejtës
- Personaliteti i njeriut dhe epërsia e tij ndaj të gjitha qenieve të tjera
- Efikasiteti i Kur'anit në shërimin e sëmundjeve morale dhe sociale
- Mrekullia e Kur'anit
- Veset djallëzore dhe paralajmërimi për besimtarët ndaj rrugëve të depërtimit të shejtanit
- Tema morale (morali familjar dhe social)
- Pjesë nga historia e profetëve, si shembuj nga të cilët duhet të nxjerrin mësim të gjithë njerëzit



Kuptimi: Udhëtimi i natës

Shkaku i emërimit: Është ajeti i parë i sures që flet për udhëtimin gjatë natës së Profetit të Islamit, Hazreti Muhammedit (paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të!) nga Mesxhidul Haram në Mesxhidul Aksa dhe vazhdimin e mëtejshëm të këtij udhëtimi që shënon dhe Miraxhin e madh të Profetit në qiej, ku ai u njoh nga afër me misteret e krijimit, njësimin dhe fuqisë së Zotit.

Emrat e tjerë: Beni Israil-Subhan

Përmbajtja e sures

- Fillon me lavdërimin e Zotit dhe përfundon me falënderim.
- Jepen argumentet e profetësisë, të Kur'anit, të Miraxhit (ngritjes me trup në qiell dhe Xhennet të Profetit Muhammed (paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të!)), të Teologjisë.
- Jeta e Përtejme dhe cështja e dënimit dhe e shpërblimit
- E kaluara dhe aventurat e popullit të Beni Israilit, dobësia, fuqia, humbja dhe fitorja e tyre, shembull, nga i cili, myslimanët duhet të nxjerrin mësim
- Të jetojmë në këtë jetë pa harruar Botën e Përtejme
- Drejtësia në të gjitha nivelet, në veçanti ndaj nënës dhe babait
- Bojkotimi i shpërdorimit, vrasjes së fëmijëve, imoralitetit,

Renditja e sures

Sipas renditjes së tubimit, është surja e 17-të, ndërsa sipas rendit të zbritjes është surja e 49-të. Ajo ka zbritur pas sures "Kasas" dhe para sures "Junus".

Historitë e sures: Miraxhi i Profetit (paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të!): ajeti 1, Musai: ajetet 101-104.

Fillimi dhe fundi

Fillimi: "Pa të meta është Lartmadhëria e Atij që robin e Vet e kaloi në një pjesë të natës prej Mesxhidi Haramit (prej Qabes) gjer në Mesxhidi Aksa (Bejti Mukades)"

Fundi: "...dhe thuaj: 'Falënderuar qoftë All'Ilahu, i Cili nuk pati fëmijë dhe nuk ka për të shok në sundim, e sa i përket aftësisë, nuk ka nevojë për ndihmës, dhe madhëroje Atë me madhërinë që i takon.'"

Përparësia e sures

Imam Sadiku (paqja qoftë mbi të!) ka thënë: "Ai, i cili lexon suren "Isra", kur arrin në këshillat e Zotit në lidhje me babanë dhe nënën, bëhet më i ndjeshëm dhe më i dashur ndaj tyre."

VDEKJA

është 'porta'e

Ahiretit

All'lahu i Madhëruar thotë në Kur'an: "A menduat se Ne ju kishim krijuar pa ndonjë qëllim dhe nuk do të mund të ktheheshit prapë tek Ne?" (El-Muminun, 115)

Gjëja më e sigurt për çdo krijesë të gjallë është se përfundimi i saj do të jetë vdekja.

Dhe, asnjë nga ata që ka vdekur nuk është kthyer sërish në jetë që të na tregojë për shijen e vdekjes dhe çfarë ndodh pas saj.

Ajo është diçka e panjohur...

Ky është dhe shkaku që njerëzit i janë trembur asaj.

Vdekje do të thotë që shpirti të ndahet nga trupi, e pas kësaj, shpirti ngjitet tek Krijuesi i Tij në vendin e quajtur (ALEM BERZEH), vend, i cili është midis dynjasë dhe Ahiretit ose vendpriftja mbas vdekjes deri në ringjallje. Trupi kthehet në dhe (baltë), prej nga u krijua, derisa të kthehet shpirti në të Ditën e Gjykimit dhe kjo është e vërteta që pohon Islami.

Ne nuk dimë asgjë rreth vdekjes dhe çfarë do të ndodhë pas saj si:

Dita e Gjykimit, Xhenneti (parajsa) dhe Xhehenemi (zjarri), përveç asaj që na ka treguar All'lahu i Madhëruar në Librin e tij të shenjtë, KUR'ANIN.

All'lahu i Madhëruar thotë në Kur'an: "Është All'lahu, i Cili merr shpirtat në kohën e vdekjes së tyre dhe ata që nuk vdesin gjatë gjumit të tyre. Ai i mban ata (shpirtat) për të cilët Ai ka vendosur vdekjen dhe i dërgon të tjerët për një kohë të papërcaktuar. Vërtet, që në këtë ka shenja treguese për popullin që mendon."

(Ez-Zumer, 42)

Fetë i kanë mësuar njeriut se kjo botë është një urë lidhëse me Botën e Përhershme - një botë në të cilën mbretëron drejtësia, ku çdo njeri shpërblehet në bazë të asaj që ka punuar në dynja (qoftë ajo e mirë apo e keqe).

Gjithashtu, civilizimi i Egjiptit të lashtë e pranonte ekzistencën e Jetës së Përhershme mbas vdekjes. Filozofia e Eknatonit është një nga filozofitë më të ndritshme që ka pjellë mendja e njeriut pasi kjo filozofi i udhëzonte njerëzit se mbas këtij krijimi ekziston një Zot i Vetëm. Ai është që ta dhuron jetën dhe dielli nuk është veçse simbol i këtij krijimi.

E vërteta është se revolucioni i Eknatonit u fashit mbas vdekjes së tij (mbas një sundimi që zgjati 17 vjet), por thirrja e tij i mahniti mendimtarët aq sa shumë prej tyre e ngritën në një shkallë shumë të lartë duke e cilësuar në mesin e dijetarëve më të mëdhenj pasi mendimi i tij i përafrohet thirrjes në një Zot.

Çfarë la pas civilizimi i faraonëve me piramidat e tyre, varret e vendosura në to, na tregojnë se ata besonin në ringjallje, duke u munduar që ti ruanin trupat e tyre të balsamosur të paprishura në pritje të kësaj ringjalljeje.

All'lahu i Madhëruar thotë në Kur'an: "Atë banesë të Jetës së Fundit (Xhennetin) Ne do ta përcaktojmë për ata të cilët nuk kundërshtojnë të vërtetën me krenari dhe shtypje në tokë dhe që nuk bëjnë as poshtërsi e krime." (El-Kasas, 83)

Por, pikëpyetja më e madhe, e cila vjen në mendjet tona, ka të bëjë me brendinë, thelbin e vdekjes dhe ajo çka e lidh gjumin me vdekjen. Dhe ndoshta, ajo që kemi lexuar në librin: "Gjumi, ëndrrat ndërmjet fesë dhe shkencës" i Prof. Dr. Ahmed Fet-hi Ez-Zijat dhe Prof. Dr. Memduh Eluekijl i përafrohet më së shumti këtij përshkrimi. Ata, pasi na tregojnë për dobritë e gjumit, përshkruajnë lidhjet ndërmjet gjumit dhe vdekjes dhe duke u mbështetur në fakte shkencore thonë:

"Ne e dimë që të gjitha teoritë nuk e kundërshtojnë natyrën e gjumit dhe thelbin e tij, por këtu është një pyetje e cila i bëhet çdo mendimtari që ta shikojë këtë temë pa asnjë anësi, pra, duke mos u mbështetur në asnjë prej versioneve. Kjo pyetje buron nga ngjashmëria e madhe ndërmjet vdekjes dhe gjumit në shumë aspekte dhe ndryshimi ndërmjet tyre në uljen e proceseve të trupit, mundësia e njeriut për t'u ngritur prej gjumit dhe pamundësia e tij për të mos vdekur (të ngjallet)..." Themni se këto mendime të çojnë në një mendim të vetëm që njeriu i gjallë përbëhet prej anës materiale që është trupi dhe në të futet diçka jomateriale që është shpirti dhe është, pikërisht, shpirti ai, i cili ndikon tek njeriu, e vë në lëvizje trupin, u përgjigjet ngacmimeve të ndryshme në mënyrë të dukshme. Shpirti shkëputet prej trupit gjatë vdekjes dhe gjumit, por kthehet sërish në trup kur zgjohet prej gjumit dhe nuk e bën një gjë të tillë kur vdes.

Disa mendojnë se jomaterialja nuk mund të ndikojë tek materialja, por Dr. Klark Kijndi, profesornë universitetin e Londrës, i kundërshton duke thënë: "Njeriu, n.q.s. dëshiron të bëjë një lëvizje të dorës, atëherë diçka jomateriale e

detyron materialen, pra, është mendimi dhe dëshira, që janë jo materiale, të cilat çojnë në lëvizjen e dorës."

Vdekja është një e vërtetë e padiskutueshme të cilës nuk i shpëton asnjë gjallesë e gjallë... Ajo është e fshehta e pazgjidhur që i ka preokupuar të gjithë mendimtarët dhe filozofët të cilët janë munduar ta zgjidhin atë dhe çfarë ka pas saj. Ajo ka ngritur shumë pikëpyetje. Për të janë shkruar mijëra libra. Është përmendur në gjuhët e miliona personave, të cilët, nëpërmjet vargjeve, kanë vajtuar të dashurit (të vdekur) e tyre, por ajo ka vazhduar të preokupojë dhe të frikësojë...

Kjo ndodh pasi njeriu nuk mund të imagjinojë



që të ringjallet pasi ka vdekur dhe trupi i tij është thërrmuar dhe kthyer në dhe (baltë), n.q.s. nuk beson në një fe, e cila e përgëzon me një jetë tjetër...

Jobsimtarët nuk besonin se njeriu pasi ishte kthyer në dhe (baltë) mund të fillonte një jetë nga e para. Por, kishte dhe nga ata arabë të cilët besonin. Ishin ata, të cilët trashëguan fenë në të cilën kishte thirrur Ibrahim (paqja qoftë

mbi të!), por, me kalimin e kohës, e harruan mëshirën që buronte nga qielli. Besuan se kjo Gjithësi e ka një Krijues, por nuk besuan në ringjallje. Ja si na e përshkruan Kur'ani i Madhëruar:

"Dhe na shëmbëllen Ne të tjerë (dhe i bën shokë e të barabartë me Ne) dhe harron krijimin e vet. (Një i tillë) thotë: "Kush do t'u japë jetë këtyre kockave kur të jenë kalbur e të jenë bërë pluhur?"

"Thuaj (O Muhammed): Ai do t'u japë jetë atyre, i Cili i krijoi për herë të parë!" (Jasin, 78) Pra, Islami është ai, i cili na e sqaron të vërtetën rreth vdekjes që është porta hyrëse për në Botën Tjetër pas largimit të shpirtit dhe ngjites së tij në (ALEM BERZEH).

Shpirti është më i hershëm dhe më i rëndësishëm se materia. Ne mund ta njohim nga shenjat e tij. Ne mund t'i shohim këto shenja kur bashkohet shpirti me trupin, pasi trupi pa shpirtin nuk ka asnjë vlerë.

"Dhe të pyesin ty o Muhammed për shpirtin. Thuaj: Shpirti është prej atyre gjërave, dija për të cilat është vetëm tek All'illahu, ndërsa nga dija (o njerëz) ju është dhënë fare pak." (El-Isra, 85)

Vdekja është e vërtetë

Njerëzit e mirë nuk e kanë frikë vdekjen dhe nuk i druhen asaj, sepse ata kanë dëshirë që të takohen me Krijuesin e tyre. Kënaqësia e tyre është shumë e madhe dhe me padurim e presin këtë takim, ndaj e kanë përgatitur shpirtin e tyre. Shpirti ngjitet në një botë, të cilën mendja e njeriut nuk e percepton dot. Vdekja për njerëzit e mirë, të singertë, është rruga që të çon në botën, të cilën ata e kanë ëndërruar për të fluturuar të përmalluar për te Krijuesi i tyre. Vdekja është ajo që ua plotëson dëshirën.

"...i Cili ka krijuar vdekjen dhe jetën, me qëllim që të provojë kush nga ju është më i miri në vepra." (El-Mulk, 2)

Pra, vdekja nuk është stacioni i fundit, por është fillimi i një jete të re...

"All'illahu është Ai, i Cili ju krijoi juve, pastaj ju siguroi ushqimin, pastaj do t'ju bëjë të vdisni,

pastaj (përsëri) do t'ju japë juve jetë (Ditën e Ringjalljes)." (Er-Rum, 40)

Atëherë jeta jonë vazhdon në (ALEM BERZEH). Atje jetojmë me shpirtin tonë... Kjo është një parapregatitje për Ditën e Madhe, Ditën në të cilën i fryhet **surit** (fyellit).

"...dhe do t'i fryhet Surit (për herë të dytë) dhe ja, ç'të shohësh... nga varret do të dalin me të shpejtë drejt Zotit të tyre. Do të thonë: 'Mjerë ne! Kush na ka ngritur nga vendi ynë i gjumit? (Do t'u thuhet): Kjo është çfarë ju pati premtuar i Gjithëmëshirshmi (All'illah) dhe të Dërguarit thanë të vërtetën (Ja, u vërtetua fjala e të Dërguarve)! Do të jetë vetëm një Saihah (thirrje e fuqishme fryrja e dytë e Surit) e vetme dhe ja! Ç'të shohësh! Ata të gjithë në pritje të sjellë përpara Nesh!" (Ja-Sin, 51-53)

Le të qëndrojmë pak me shembullin që sjell Dr. Rauf Ubejd, në të cilin tregon për përpjekjet e dijetarëve për të kuptuar pasojat e vdekjes dhe daljen e shpirtit nga trupi. Ai na tregon shembujt e atyre personave që janë aksidentuar dhe atë çka kanë përjetuar gjatë kohës që ju është bërë ndërhyrja mjekësore, për gjërat e çuditshme që ata kanë parë. Ata kanë parë çdo gjë që ndodh rreth tyre, si dhe ndërhyrjet që u janë bërë, derisa kanë dalë nga gjendja e komës, në të cilën kanë qenë.

Nuk ka dyshim, se përfundimi në të cilin arrin njeriu me gjithë teknologjinë e zhvilluar është se vdekja nuk është shkatërrim për të, por një lindje (jetë) e dytë në Botën Tjetër, ose e thënë ndryshe, ashtu siç e ka thënë Ajshtajni: "Vdekja është pasaportë për në një vend tjetër."

Vdekja është e sigurt dhe ringjallja është e sigurt, pasi feja islame na ka siguruar për këtë. Çdo punë të mirë apo të keqe që bëjmë, qoftë ajo e madhe apo e vogël, do na peshojë në peshoren tonë Ditën e Gjykimit.

"Kushdo që bën mirësi, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë dhe kushdo që bën keq, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë." (Ez-Zelzele, 7-8)

Përktheu: Pëllumb Jaupi



Tregues i emrave myslimanë

1	Firdeze (Firdeuseh)	Firdez	Grada më e lartë e Xhennetit
2	Ganimete (Ganijmeteh)	Ganimet	Pasuri e fituar në luftë
3	Habibe (Habibeh)	Habibe	E dashur
4	Hajrie (Khajrij'jeh)	Hajrije, Rije, Riku	Mirësi
5	Halime (Halijmeh)	Halime, Halëme	Butësi
6	Faruk (Fàrùk)	Faruk	Ndarës, epiteti me të cilin u thirr Ymer bin Elkhat'tàbi
7	Faslli (Faslij)	Faslli	Ndarës i sendeve
8	Fazlli (Fadlij)	Fazlli	Dhënës më shumë se nevoja
9	Fejzi (Feuzij)	Fejzi	Fitues
10	Fejzulla (Fejdullàh)	Fejzulla, Fez, Fejzo	Ecës në rrugën e All'Ilahut

Pozita e zemrës në Kur'an



Zemra u krijua nga drita dhe hijeshia dhe të parin që pa ishte Zoti i Madhëruar.

Kur'ani famëlartë i ka kushtuar rëndësi të madhe zemrës, të cilën e konsideron edhe qendrën e Komandës të njeriut, dhe, në mënyrë që njeriu të përftojë mrekullitë njerëzore, duhet të shfrytëzojë më së miri organet e veta. Kur'ani e inkurajon njeriun për të forcuar zemrën e tij.

Zemra, në pikëpamjen e Kur'anit është boshti i kuptimit të thellë. Zemra qetësohet me përmendjen e Zotit dhe duke harruar përmendjen e Tij infektohet nga sëmundjet shpirtërore. Prandaj, nëse kjo qendër komanduese do të jetë e shëndoshë, organet e tjera të trupit do të kryejnë më së miri funksionin e tyre duke ecur në rrugën e përsosmërisë.

Kur'ani famëlartë e fton njeriun të ketë një zemër të bindur, të sigurt, të dorëzuar dhe të frikësuar përballë madhësisë të Zotit dhe kritikon njeriun i cili ka një zemër të ndryshkur, të sëmurë, e cila ka devijuar nga qëllimi i lartë.

"A nuk është koha që zemrat e atyre që besuan të zbuten me këshillat e All'Ilahut dhe me atë, të Vërtetën që zbriti (me Kur'anin), e të mos bëhen si ata, të cilëve u është dhënë Libri më parë, e zgjati koha dhe zemrat e tyre u shtangën e shumë prej tyre janë jashtë rrugës." (Sure Hadid, ajeti 16)

Karakteri i çuditshëm i njeriut

Njeriu ka veçori të çuditshme. Karakteri i tij i vërtetë del në pah kur vihet përballë provës hyjnore. Kur atë ta zërë ndonjë e keqe, e shikon natë e ditë duke u lutur dhe me zemër e shpirt i kërkon Zotit të Madhëruar që ta ndihmojë dhe nëse vështirësitë ndaj tij shtohen më shumë, lutet aq shumë sa nuk është lutur ndonjëherë më parë, dhe kur lutja i pranohet dhe i lehtësohet vështirësia, gëzohet aq shumë saqë harron se në ç'hall ishte ai dhe kush e shpëtoi. Por njeriu, që në ditën e parë ka qenë harraq. Dhe shkaku pse kjo krijesë u quajt njeri (insan) është nga harresa e tij. Ai e di më së miri se, vazhdimisht, vihet para sprovës hyjnore me qëllim që të matet forca e besimit të tij dhe të bëhet e ditur për të nëse i lëkundet besimi në kohë të vështira apo jo.

Lidhur me këtë karakter të çuditshëm të njeriut, në ajetin 49 të sures Zumer flitet kështu:

"Kur e godet njeriun ndonjë e keqe, ai na lutet Neve, e kur nga ana Jonë ia shndërrojmë atë në ndonjë të mirë, ai thotë: 'Kjo më është dhënë në bazë të dijes sime!' Jo, por ajo është një provë, por shumica e tyre nuk e dinë."

Shadithe

Njerëzit më të dashur te Profeti

(paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të!)

Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të!) ka thënë: "Më i dashuri dhe më i afërti te unë në Ditën e Gjykimit, është ai që ka moral më të mirë dhe që është më i thjeshti." (Biharul Anuar, 71/ 385 /26)

Shpëtueset në Ditën e Kijametit

Profeti Muhammed (paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të!) ka thënë: "Tri gjëra janë shpëtuese: ... frika ndaj All'Ilahut në fshehtësi, sikur ti e sheh Atë. Nëse nuk e sheh, Ai të sheh ty." (Biharul Anuar, 70/ 7/ 5.)

Qëndrueshmëria e popujve

Profeti Muhammed (paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të!) ka thënë: "Vërtet, nëse All'Ilahu i Madhëruar e do qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e një populli, u jep atyre udhëzimin dhe pastërtinë." (Ed Derul Menthur, 3/ 270)

Profeti Muhammed (paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të!) ka thënë: "Kujtoje All'Ilahun në lehtësi, të të kujtojë ty në vështirësi." (Biharul Anuar, 77/ 87/ 3.)

Profeti Muhammed (paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të!) ka thënë: "Nuk ka punë më të dashur te All'Ilahu e as punë që e shpëton njeriun prej të këqijve të dynjasë e të Ahiretit, se sa përmendja e Tij. Atij i thanë: "As lufta në rrugën e All'Ilahut?" Ai tha: "Nëse nuk do të ishte përmendja e All'Ilahut, nuk do të urdhërohej për luftë." (Kenzul Ummal, 3931.)

Shfrytëzimi i kohës me përmendjen e All'Ilahut

Profeti Muhammed (paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të!) ka thënë: "Çdo orë që i kalon birit të Ademit dhe nuk e përmend All'Ilahun, do të jetë mjerim për të në Ditën e Gjykimit." (Kenzul Ummal, 1819.)

Përmendja e All'Ilahut

Profeti Muhammed (paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të!) ka thënë: "Përmendja e All'Ilahut është shërim për zemrat." (Kenzul Ummal, 1751.) Profeti Muhammed (paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të!) ka thënë: "All'Ilahu e frymëzoi një prej të Dërguarve të Tij: "Bir i Ademit, më kujto në zemërimin tënd, të të kujtoj ty në zemërimin Tim."

Sjellja e dynjasë nëpërmjet fesë

Profeti Muhammed (paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të!) ka thënë: "Mjerë ata të cilët e afrojnë dynjanë nëpërmjet fesë; veshin për njerëzit lëkurat e buta të deles; fjalët e tyre janë më të ëmbla se mjalti dhe zemrat e tyre janë zemra ujqërish. All'Ilahu i Madhëruar thotë: "Mua më mashtrojnë?" (Al'amu Dijn, 295.)

Përgjegjësia e udhëheqësit ndaj masës

Profeti Muhammed (paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të!) ka thënë: "Të gjithë ju jeni ruajtës dhe të gjithë ju jeni përgjegjës për masën e tij. Prijësi i njerëzve është përgjegjës për masën e tij. Burri është përgjegjës për familjen e tij dhe gruaja është ruajtëse e shtëpisë së burrit të saj dhe e fëmijëve. Ajo është përgjegjëse për ata." (Sahihu i Muslimit.)

Pse unë duhet të mbaj hixhab?


All'Ilahu na ka urdhëruar në çdo vepër që është e mirë për ne dhe na e ka ndaluar çdo vepër që është haram për ne. All'Ilahu e urdhëron gruan myslimane që të mbajë hixhab kur ajo del nga siguria e shtëpisë së saj, apo në prani të njeriut të huaj, pra, mbajtja e hixhabit është burim i një të mire të madhe për ty - grua myslimane - për shumë arsye. Në mesin e tyre shkëputim:

- Ti e kënaq All'Ilahun, ti u bindesh urdhreve të Zotit Tënd kur mban hixhab dhe mund të presësh shpërblime të mëdha për këtë.
- Kjo është mbrojtje e bukurisë tënde natyrore nga All'Ilahu, ti je tepër e çmuar që ti ekspozohesh çdo njeriu.
- Kjo është ruajtje e nderit tënd nga All'Ilahu.
- All'Ilahu e pastron zemrën dhe mendjen tënde përmes hixhabit.
- All'Ilahu e zbukuron paraqitjen tënde të jashtme dhe të brendshme me hixhab. Së jashtmi hixhabi yt reflekton çiltërsi, dëlirësi, modesti, drojë, qetësi, kënaqësi dhe bindje ndaj Zotit tënd. Së brendshmi ti e kultivon të njëjtën gjë.
- All'Ilahu e përkufizon feminitetin tënd përmes hixhabit. Ti je gruaja e cila e respekton feminitetin. All'Ilahu do që ti të respektohesh nga të tjerët dhe ta respektosh vetveten.
- All'Ilahu e lartëson dinjitetin tënd përmes hixhabit. Kur ndonjë i huaj shikon në ty, ai



të respekton sepse sheh se ti e respekton veten tënde.

- All'Ilahu e mbron nderin tënd 100% përmes hixhabit tënd. Meshkujt nuk të shohin ty në mënyrë sensuale, ata nuk të afrohen në mënyrë sensuale e as që të flasin në mënyrë sensuale. Më saktë, burri të respekton dhe kjo është vetëm



me një shikim të shpejtë!

- All'lahu të fisnikëron përmes hixhabit. Ti je bujare e jo e degraduar sepse je e mbuluar e jo e zhveshur.
- All'lahu e përkufizon rolin tënd si një grua myslimane përmes hixhabit. Ti je krijesë me detyra të rëndësishme. E shfaq sensin tënd të orientimit dhe qëllimit përmes hixhabit tënd. Ti je dikush që njerëzit e vlerësojnë seriozisht.
- All'lahu e shpreh pavarësinë tënde përmes hixhabit. Ti deklaron qartazi se je një rob i dëgjueshëm i Zotit të Madhëruar. Ti s'do të dëgjosh askënd tjetër dhe s'do të pasosh rrugë tjetër. Ti s'je rob i ndonjë njeriu e as rob i ndonjë populli. Ti je e lirë dhe e pavarur nga të gjitha sistemet e krijuara nga njeriu.
- All'lahu të jep ty liri të lëvizjes dhe të shprehjes përmes hixhabit. Ti ke mundësi të lëvizësh dhe të komunikosh pa pasur frikë nga keqtrajtimi. Hixhabi yt të jep një vetëbesim të veçantë.
- All'lahu do që të tjerët të trajtojnë ty – një grua myslimane - me mirësi dhe hixhabi sjell trajtimet më të mira të burrave ndaj teje.
- All'lahu do që bukuria jote të ruhet vetëm për një mashkull - burrin tënd.
- All'lahu të ndihmon ty që të kënaqesh

në një martesë të sukseshme përmes mbajtjes së hixhabit. Për shkak se ti e rezervon bukurinë tënde vetëm për një njeri, dashuria e burrit tënd ndaj teje shtohet. Ai të do më shumë, të respekton më shumë dhe të nderon më shumë. Pra, hixhabi yt i kontribuon marrëdhënies së sukseshme dhe të qëndrueshme martesore.

- All'lahu sjell paqe dhe stabilitet në shoqëri përmes hixhabit. Po, kjo është e vërtetë. Meshkujt nuk shkaktojnë çrregullime duke formuar marrëdhënie të paligjshme sepse ti - grua myslimane - i qetëson pasionet e tyre. Kur mashkulli të

shikon ty, ndihet i qetë e jo i joshur që të veprojë gabim, pra gruaja myslimane në hixhab është dinjitoze, jo e çnderuar, bujare, jo e degraduar, e lirë, jo e nënshtruar, e pastër, jo e njollosur, e pavarur, jo e robëruar, e mbrojtur, jo e ekspozuar, e respektuar, jo e përqeshur me besim në vetvete, jo e pasigurt, jo një gjynahqare, një perlë e ruajtur, jo një prostitutë...

E dashur motër myslimane, eja drejt portave të Xhenetit! Përmeshi detyrat e tua ndaj All'lahut, vendose zbukurimin tënd - vendose hixhabin tënd, dhe garo drejt Xhenetit duke bërë të gjitha veprat e mira. Ti duhet të pajtohesh tashmë se mbajtja e hixhabit është tejet e dobishme - edhe duhet të jetë - sepse All'lahu na urdhëron vetëm në të mirën...

"Shpërblimi i tyre është te Zoti i tyre: 'kopshtet e Adnit nën të cilat rrjedhin lumenjtë ku ata do të jetojnë përgjithmonë; All'lahu është i Kënaqur me ta dhe ata janë të kënaqur me Të; kjo është (përgatitur) për këdo që i frikësohet Zotit të vet.'" (Bejjine, 8).

Përgatiti: Suzana Pisha

KLONIMI

rrënimi i vlerave etike, morale dhe fetare

Islami gjatë historisë së tij, gjithmonë ka pranuar i përgatitur zhvillimin shkencor. Kërkimi i diturisë për mirëqënien njerëzore ka qenë thellë i inkorporuar në Islam dhe paraqet detyrim kolektiv për myslimanët. Në Kur'anin famëlartë, All'illahu i Madhëruar thotë se i ka dhuruar njeriut intelektin dhe shumë vlera natyrore që i mundësojnë ligjet e natyrës, duke e detyruar njëherazi që t'i zhvillojë deri në shkallën më të lartë, në mënyrë që t'i kënaqë nevojat e tërë njerëzve.

Kujtojmë ajetin kur'anor: "All'illahu është Ai, që krijoi për ju gjithçka që ka në tokë, pastaj vullnetin e Vet ia drejtoi qiellit dhe i përsosi ata shtatë qiej. Ai është i Gjithëditur për çdo gjë." (El Bekare, 29)





Inxheneringu gjenetik – manipulimi i përafërt me materialin trashëgues

Hulumtimet fillestare në inxheneringun gjenetik janë shpallur pas zbulimit të ndërtimit si dhe të funksionimit të materialit trashëgues. Substanca trashëguese janë ADN, gjenet dhe kromozomet.

Inxheneringu gjenetik është term për manipulimin e përafërt me materialin trashëgues. Këto manipulime kryesisht përbëhen nga transmetimi i materialit trashëgues nga një sistem i gjallë në tjetrin, ku ndodhin ndryshime në disa cilësi të atij sistemi. Në bazë të sasisë së manipulimit të ndërmarë dallojmë: inxheneringun gjenetik, kromozomik dhe gjenomik. Në kuptimin e ngushtë të fjalës është bërë zakon që me kuptimin e inxheneringut gjenetik të kuptohet manipulimi dhe prodhimi i ADN rekombinante.

Edhesot e kësaj dite çështjet e koklaviturave të cilat merret gjenetika tërheqin si njerëzit e rëndomtë, ashtu edhe shkencëtarët eminentë, të cilët shpesh janë stepur para zbulimeve të çuditshme. Ata janë çuditur se si natyra e gjallë i përcjell të dhënat për ndërtimin e jetës nga njëra gjeneratë në gjeneratën tjetër. Është interesante se si një

substancë aq e vogël, e cila nuk shihet as me mikroskop elektronik, i përmban të gjitha informacionet lidhur me vetitë e veçanta të secilit lloj dhe si përcillen ato pa gabime.

Kujtojmë ajetin kur'anor: "Vetëm Atij i takon sundimi i qiejve dhe i Tokës. Ai nuk ka as fëmijë e as nuk ka shok në sundimin e Tij. Ai krijoi çdo gjë, duke e përsosur në mënyrë të qartë e të matur." (El Furkan, 2)

Por a është ADN gjithçka? A është ADN e vetmja gjë që na bën qenie njerëzore? Studimi i "vezëve të njëjta binjake" siç ndodh në rastin e klonimit, na tregon se ne posedojmë shumë më tepër se ADN. Në këtë mënyrë, mund të shohim se rrethanat janë faktor i rëndësishëm ndikues në sjelljen e njeriut. Me rrethana nënkuptojmë shoqërinë më të afërt, kulturën, fenë dhe vlerat morale, me një fjalë, e gjithë ajo që e dallon njeriun nga shtazët. Qeniet njerëzore posedojnë një veçori të posaçme të dhuruar nga All'illahu i Madhëruar – shpirtin. Edhe pse natyra e shpirtit mbetet mister, ekzistenca e tij ndihet thellë në ndërgjegje dhe na jep natyrë të veçantë që dallohet nga format jonjerëzore të jetës.

Dhurata pa vlerë

Mbrei tha: Sot kam vendosur që të dëgjoj fjalën tënde, dua të bëj një punë të hajrit.

Behluli, i habitur nga ajo që dëgjoji, tha: Ti punë të hajrit?! E habitshme! Mbreti nxori një qese me para që ndodhej poshtë jastëkut të shtratit të tij e ia dha Behlulit.

Behluli e pyeti: Ç'të bëj me këtë qese parash?

Mbreti iu përgjigj: Shpërndaji mes të varfërve e mes atyre që kanë nevojë dhe kthehu shpejt. Behluli e vështroi i habitur. Nuk

i besoj se mbreti po mendonte për të varfrit e për nevojtarët. U ngrit nga ku ishte ulur e u largua nga kështjella.

Për një kohë të gjatë u vërdallos nëpër rrugicat e Bagdatit. Sapo shihte një fukara të rraskapitur e me rroba të vjetëruara, thoshte me vete: Ky njeri është i varfër e nevojtar-, por largohet pa i dhënë para.

Deri në aksham, rrugicë me rrugicë shkoj, por të njëjtën gjë bëri. Kur u errësua, u kthye në kështjellë.

Mbreti, sapo e pa Behlulin, i tha: Sa shumë që u vonove?! Kaq shumë kohë duhet për të shpërndarë një qese me para mes nevojtarëve?

Behluli nxori qesen e parave nga xhybja e tij e arnuar dhe e vendosi para mbretit. Mbreti i habitur, pyeti: - Përse nuk ua dhe paratë të varfërve?

Behluli iu përgjigj: - Nuk lashë rrugicë e vend pa parë në qytet, por më të varfër e më nevojtar se sa ti nuk gjeta, prandaj, paratë i solla që të

ti jap ty. Mbreti kur dëgjoji fjalët e Behlulit u nevrkos e tha: Unë të dërgova për punë të rëndësishme e ti çdo gjë e merr me shaka. A nuk je ti ai që me mijëra herë më thoje që të ndihmoj të varfërit?

Behluli u përgjigj: Ç'të mirë ka këtu? Ti sot po ua jep këto para, nesër ushtarët e tu ua marrin me dhunë e i hedhin në kasafortën tënde. Më mirë është që ushtarët të mos lodhen dhe këto para ruaji në kasafortë. Ju jeni më nevojtar se çdokush tjetër.

Përktheu: Sabrie Feza



MENDIMI DHE LOGJIKA

në Kur'an

Në qenien e njeriut, asnjë dhunti nuk ka vlerë më jetike e njerëzore sesa arsyeja dhe fuqia e mendimit. Roli që luan arsyeja në drejtimin dhe udhëzimin e njeriut drejt suksesit dhe lumturisë, si dhe, në zgjidhjen e problemeve themelore, nuk mund të krahasohet me asnjë forcë tjetër. Zakonisht, dhuntitë dhe begatitë e Zotit, dhënë njeriut mund të shfrytëzohen e të jenë të dobishme vetëm në kohën kur ata janë të kontrolluara dhe të drejtuara drejt së mirës, e kjo gjë arrihet nëpërmjet veprimit të fuqisë së arsyes dhe logjikës së njeriut.

Përballja e njeriut me bekimet e tjera si besimi, urtësia, njohuria, si dhe, dëshirat materialiste kalimtare, të gjitha këto kalojnë nëpërmjet mendjes dhe arsyes së njeriut. Çdo lloj lëvizjeje materiale apo shpirtërore e njeriut urdhërohet nga fuqia e madhe dhe e shenjtë e mendimit.

Cila është ajo aftësi tjetër njerëzore e cila e udhëheq njeriun drejt rrugës së shpëtimit duke bërë që njeriu të dallojë rrugën e drejtë nga e gabuara?

Tregohet nga Profeti i nderuar të ketë thënë: "Zoti, robve të Tij nuk u ka falur gjë më të mirë sesa arsyeja. Gjumi i mendimtarit është më i mirë sesa zgjimi i injorantit. Qëndrimi në shtëpi i mendimtarit është më i mirë sesa udhëtimi (për në Haxh) i injorantit dhe Zoti nuk e dërgoi Lajmëtarin e Tij pa arritur ai pjekurinë e logjikën e tij të plotë dhe logjika e tij të ishte lart mbi çdo logjikë të ummetit të vet..."

Edhe pse logjika e arsyeja nuk është e njëjtë mes të gjithë njerëzve, çdokush me atë kapacitet mendimi që ka, duke e vënë në punë atë ashtu siç duhet, mund të përfitojë duke gjetur rrugën e ngritjes së vetvetes dhe të fitojë të mirat shpirtërore dhe materiale. Hoxhë Abdullah Ensari thotë: "O Zot! Atij që i dhe arsyen, çfarë nuk i ke dhënë dhe atij që nuk i dhe arsyen, çfarë i ke dhënë?!" Askush nuk mund të kritikohet apo akuzohet sepse paska një dhunti më të ulët në arsyetim ose nuk ka fare logjikë. Por çdokush, me aq mend sa ka, duhet të përpiqet për gjetjen e rrugës së vërtetë dhe të lumturisë. Çdo njeri duhet ta vërë në punë mendjen për të dalluar të mirën nga e keqja dhe për t'u përballur me problemet e përditshme.

Një herë, Profeti i nderuar i tha Bilalit që një natë më parë, Zoti i kishte shpallur disa ajete shumë tronditëse dhe filloi t'i këndonte ato. Pastaj, tha: "Mjerë ai që i dëgjon këto ajete dhe nuk mendon për to."

Shumë dijetarë të mëdhenj nuk mendojnë për Zotin si krijues të gjithë kësaj Gjithësie, kështu, ata nuk arrijnë në rezultatet e vërteta të nevojshme për racën njerëzore. Kjo është si puna e atyre njerëzve që hajnë ushqim të mirë dhe vetëm trupin forcojnë, ndërsa mendja e shpirti nuk ndikohen aspak nga kjo gjë.

Mendimi dhe arsyeja, për sekretet e krijimit, i japin njeriut një vetëdije të veçantë. Gjëja e parë që vihet re është mosekzistenca pa

qëllim e të gjithë krijimit. Po kështu, kur njeriu shikon dhe në krijesën më të vogël që ka një qëllim, atëherë a mund të mendojë ai se e tërë kjo botë është pa ndonjë qëllim të qartë?

Madje, edhe në strukturën e një bime sado të vogël vihet re një qëllim i qartë. Zemra e njeriut, damarët dhe aorta, të gjitha këto, e kanë një qëllim. Edhe sistemi i syrit, madje, edhe qerpikët e kanë një qëllim e një funksion të qartë. A është e mundur që njëra pjesë e një krijese të ketë qëllim e të tjerat të jenë kot?

Dijetarët duke i kushtuar vëmendje këtij realiteti thonë: "O Zot, tërë këtë aparat të madh nuk e ke ndërtuar pa qëllim." E pas këtij rrëfimi, ata bien në mendime lidhur me krijimin e vetes së tyre dhe e kuptojnë se edhe ata si fryt i kësaj bote nuk janë krijuar

kot, porse ata kanë sekrete dhe rrugë tjetër për të ecur. Si përfundim, ata i pranojnë përgjegjësitë e tyre dhe kërkojnë prej Zotit ndihmë në punët e mëtejshme.

Është interesante të themi që në 46 raste në Kur'an ftohet njeriu drejt mendimit dhe arsyes, ku përkrahen ata që e vënë në punë mendjen e tyre, ashtu si dhe, kritikohen ashpër ata që nuk e vënë në përdorim arsyen. Po kështu, lidhur me temën e të arsyetuarit, nga ana e dijetarëve e teologëve janë thënë kaq shumë gjëra sa që po të duam t'i përmendim të gjitha ato, na duhet të shkruajmë një libër të posaçëm. Këtu na mjafton të themi që Kur'ani, një ndër dallimet që u bën banorëve të ferrit është se ata nuk e kanë vënë në punë mendjen dhe logjikën e tyre. Banorët e ferrit thonë:

"Nëse ne do të kishim veshë për të dëgjuar dhe mendje për të menduar, nuk do të gjendeshim në ferr."

Në një vend tjetër thuhet: "Ata që kanë veshë e nuk dëgjojnë, kanë sy, por nuk shikojnë, kanë mendje, por nuk mendojnë, janë bërë *kandidat* për në ferr."

"Është e qartë, që një grup të madh xhindesh i kemi caktuar për në ferr. Shenja dalluese e tyre është se ata kanë mendje, por nuk logjikojnë, kanë sy, por nuk shikojnë, kanë veshë, por nuk dëgjojnë, ata kanë katër këmbë, por janë të humbur."

Po kështu, "mendimi" është shpirti i "përmendjes" dhe pa përmendjen e Zotit, nuk është asgjë vetëm se dërdëllitje. Ajo gjë, e cila e vë njeriun në rrugë të drejtë, është



pikërisht përmendja e Zotit dhe Zoti në ajete të shumta të Tij, e fton njeriun drejt të menduarit.

Pa dyshim, që një ndër shërbimet e Kur'anit, është mësimi dhe njohja. Në këtë pikëpamje, spektatori i Kur'anit do të jetë arsyeja dhe se vetë Kur'ani do të flasë me gjuhën e arsyes, mirëpo, disa kujtojnë se njeriu nuk mund të fitojë logjikën duke lexuar Kur'anin dhe se ai është vetëm një libër fetar, ku në të nuk bëhet shkencë e filozofi. Ndjekësit e kësaj teorie e shpjegojnë kështu atë:



Fjalët e shumta sekrete dhe të pazbuluara të Kur'anit, sundojnë mbi logjikën dhe arsyen. Logjika që gjendet në Kur'an është logjikë që ka ardhur nëpërmjet përvojës. (pra është eksperiencia e problemeve të përditshme të jetës). Kjo logjikë është e rrjedhshme si jeta, e ajo nuk është një logjikë arsyetimi sipas mënyrës filozofike. Prandaj, për këtë arsye, lindi dhe shkenca e tefsirit (komentimit të Kur'anit) që u ndikua prej filozofisë së Aristotelit e cila i mveshi arsyen dhe logjikën Kur'anit. Kjo është gabim dhe myslimanët e sotëm kanë rënë sërish nën këtë grackë, saqë ata sot kërkojnë në Kur'an dhe zbulimin e atomit... Kur'ani, më shumë se çdo gjë tjetër, është një Libër fetar.

Ndërkohë, mësuesi, i ndjeri Shahid Murteza Motahari, mendimin dhe arsyen e njeriut e quan si gjuhë shprehëse të Kur'anit dhe se arsyeja vjen duke lexuar këtë libër të shenjtë. Për ta provuar këtë gjë, ai sjell shumë argumenta nga Kur'ani vetë. Lidhur me këtë, thotë:

“Megë ne po bisedojmë lidhur me Kur'anin,

është e nevojshme që argumentat për arsyen e logjikën t'i nxjerrim nga vetë Kur'ani. Kur'ani, në mënyra të ndryshme, i ka vënë vulën legjitimitetit të arsyes. Në Kur'an janë afro 60-70 ajete që e ftojnë njeriun drejt logjikës dhe mendimit. Duhet thënë, se rruga më e mirë për të vënë logjikën në punë është perceptimi dhe mendimi lidhur me atë çka thotë Kur'ani. Përdorimi i kësaj dhuntie hyjnore për të kuptuar të vërtetat dhe dijen e Kur'anit, përveç rezultatit shkencor sjell dhe lumturinë e suksesin në jetë. Kjo është vetë një çështje për të cilën

Kur'ani ka dhënë ftesën e tij, dhe atë e ka ripërsëritur disa herë, dhe ata të cilët nuk e vënë mendjen në punë për këtë realitet, nuk arrijnë gjëkund.

Ftesa e Kur'anit Fisnik drejt mendimit

Ajete të shumta të Kur'anit fisnik në forma dhe mënyra të ndryshme e ftojnë njeriun drejt mendimit dhe arsyetimit. Dhe “për njerëzit që nuk mendojnë”, e ka fjalën për ata të cilët nuk e vënë në punë mendjen për të përfituar prej të mirave të krijimit. Kur'ani këto lloj njerëzish i quan më të ulët se edhe vetë kafshët dhe në një vend tjetër i quan si të ndyrë. Atyre u thuhet, të ndyrë, mohues dhe të pafë që nuk kanë logjikë. Kur'ani në ajete të shumta të tij e fton njeriun drejt mendimit dhe logjikës duke firmosur zyrtarisht dokumentin e aprovimit të arsyes. Kështu edhe Profetit të Islamit i thuhet që kundërshtarin e vet ta bindni me logjikë, e kjo tregon edhe një herë pozitën e lartë të arsyes, e cila është e nevojshme për provimin e Njëshmërisë së Zotit.



Njoftim

NË PRAG TË DITËLINDJES SË PROFETIT MUHAMMED

(paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të!)

Me këtë rast, Fondacioni i Kur'anit organizon **konkursin e radhës, "Profeti Muhammed – Simbol i Dashurisë"**. Konkursi do të përmbajë një test të përbërë nga 40 pyetje me alternativa dhe do të botohet në një gazetë ditore. Për informacione, kontaktoni në adresën:

Rr. Hoxha Tahsim, Nr. 168; Kutia Postare: 8272;

Tel & Fax: 00355 42 377 311, Tirana – Albania

WebSite: www.fquran.com; E_mail: f_quran114@yahoo.com

Fituesit e vendit të parë, të dytë dhe të tretë do të kenë shpërblime, ndërsa për fituesit e vendit të katërt dhe të pestë do të ketë dhurata simbolike.

Jeni të mirëpritur!

Panairi i 11-të i Librit në Tiranë

Më 14 Nëntor 2009, u hap Panairi i 11-të i Librit në Tiranë, i cili u zhvillua në ambientet e Pallatit të Kongreseve dhe qëndroi i hapur për vizitorët për 5 ditë. Fondacioni i Kur'anit mori pjesë edhe këtë vit, si çdo vit tjetër, duke paraqitur në stendë edhe librat më të rinj të botuar. Ditën e parë, Panairi u përshëndet nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, z. Bamir Topi, Kryeministri i Shqipërisë, z. Sali Berisha, Kryetari i Bashkisë së Tiranës, z. Edi Rama të cilët përshëndetën të gjithë pjesëmarrësit duke vizituar stendat me libra. Stenda jonë u vizitua nga shumë dashamirës të librave fetarë. Shumë personalitete të artit dhe të letërsisë morën libra dhuratë nga Fondacioni i Kur'anit në shenjë mirënjohjeje për vlerësimin nga ana e tyre. Ne shpresojmë që nga viti në vit stenda jonë të pasurohet me libra të rinj të botuar, në mënyrë që të kënaqim të gjithë dashamirësit e literaturave islame të të gjitha niveleve dhe grupmoshave.





Një përshkrim i shkurtër mbi jetën e Profetit

(paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të!)

Të hënë, ditën e 12-të të Rebi-ul Ev-velit të vitit të Elefantit, Emineja lindi djalë. All'Ilahu u dërgoi njerëzve shumë shenja, para ardhjes së të Dërguarit. Edhe në atë ditë të 12-të të Rebi-ul Ev-velit, në vitin 570 të erës së re ishin vënë re shumë shenja. Babai i të Dërguarit të All'Ilahut quhej Abdullah, i biri i Abdul Mutalibit dhe nëna e tij quhej Emine. Profeti Muhammed (paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të!) rrjedh nga familja e Ismailit (paqja qoftë mbi të!), i biri i profetit Ibrahim (paqja qoftë mbi të!). Abdullahi, babai i Profetit nuk arriti ta shihte të birin, pasi kishte ndërruar jetë përpara se të lindte Profeti. Për të gëzuar një shëndet të mirë, Emineja bashkë me gjyshin e Profetit ia dha nën kujdes Halimesë, e cila i takonte fisit të beni Saidëve të kujdesej për rritjen e tij deri në moshën 6 vjeç. Kur arriti në moshën 6 vjeçare, Profeti humbet të dy prindërit. Në një rrugëtim te fisi i nënës, ajo sëmuret dhe vdes. Atë e merr nën kujdes gjyshi i tij, Abdul Mutalibi, i cili pas 2 vjetësh ndërron jetë. Për Profetin do të kujdesej xhaxhai i tij, Ebu Talibi. Në këtë kohë, Profeti e ndihmonte xhaxhain e tij në punë dhe një ditë ai e mori me vete për një udhëtim në Siri. Në këtë udhëtim ndodhi një mrekulli, sepse karvanin me të cilin udhëtonte Profeti e shoqëronte një re e bardhë, të cilën e vuri re murgu Behira. Ai kishte lexuar në shkrimet e vjetra se kjo nuk mund t'i ndodhte njeriu tjetër, përveç profetëve dhe ai kishte lexuar se pas hazreti Isait (paqja qoftë mbi të!) do të vinte një i Dërguar. Kështu, ai urdhëroi Ebu Talibin që ta ruante Muhammedin dhe të kujdesej mirë për të. Kur arriti moshën 25- vjeçare, ai u martua me vejushën Hadixhe, një grua e nderhme dhe e pasur nga fisi i kurejshëve. Ai njihej nga të gjithë si njeri besnik, i sjellshëm, i drejtë dhe për këtë, në kohën kur fiset arabe po diskutonin për vendosjen e gurit të zi në Qabe se cilit i takonte, atë e zgjidhi me mjaft urtësi Profeti. Kur arriti në moshën 40- vjeçare atij i erdhi Shpallja me anë melekut Xhebrail (paqja qoftë mbi të!). Patë mjaft kundërshtarë, të cilët e munduan shumë, por ai asnjëherë nuk hoqi dorë nga thirrja për në rrugën e Zotit. Për 23 vjet me radhë ai thirri në rrugën e Zotit dhe sot më shumë se gjysma e botës besojnë në Profetin Muhammed (paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të!). Në moshën 63 - vjeçare ndërroi jetë, por porosinë dhe këshillat e tij i përqafojnë çdo ditë njerëzit për të arritur kënaqësinë e Zotit të Madhëruar.



